



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA	
QEVERIA E KOSOVES-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA	
MINISTRIA E SHENDETESISË-MINISTARSTVO ZDRAVSTVA-MINISTRY OF HEALTH	
Njesia Org. Org. Jedinica Org. Unit	01
Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.	05-3373
Nr. faqeve Br. stranica No. pages	-49-
Data: Datum: Date:	02/06/2023
Prishtinë / a	

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria-Vlada-Government**  
Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health  
Zyra e Ministrit/Ured Ministra/Office of the Minister

Nr. 95/VI/2023  
Datë: 01.06.2023

Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të Nenit 145 (pika 2) e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare Nr. 7, 01 Mars 2019), nenin 11, paragrafi 1.5 të Ligjit nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, bazuar në nenin 8 të Rregullores Nr.02/2021 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (08.06.2020), nxjerr:

**V E N D I M**

- I. Aprovohet plani i veprimit për promovim dhe edukim shëndetësor 2023-2025.
- II. Shtojce e këtij vendimi është, plani i veprimit për promovim dhe edukim shëndetësor 2023-2025.
- III. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ministri i Shëndetësisë.



**Vendim i dërgohet:**

- Sekretarit të Përgjithshëm;
- Departamenti ligjor;
- Arkivit të MSh.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria -Vlada-Government*  
Ministria e Shëndetësisë/Ministarstvo Zdravstva/Ministry of Health

# **PLANI I VEPRIMIT PËR PROMOVIM DHE EDUKIM SHËNDETËSOR 2023 - 2025**

*Prishtinë, 2023*

## **Përmbajtja**

FJALA E MINISTRIT .....	5
1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE .....	6
2. HYRJE .....	8
3. METODOLOGJIA .....	11
4. SFONDI.....	12
4.1. Konteksti ndërkombëtar .....	12
4.2. Konteksti vendor .....	15
4.3. Roli dhe ndikimi i edukimit në shëndet dhe mbrojtje shëndetësore .....	15
4.4. Ndikimi i rrethit të ngushtë dhe të gjërë shoqëror në shëndet .....	18
4.5. Qasja multisektoriale.....	23
5. TË GJETURAT NGA SWOT ANALIZA.....	26
6. OBJEKTIVAT.....	28
7. ARANZHIMET E ZBATIMIT, MONITORIMIT DHE RAPORTIMIT .....	30
8. NDIKIMI BUXHETOR DHE ZBATIMI I PLANIT STRATEGJIK.....	31
9. LITERATURA.....	32

## Shkurtesat

AMMK	Agjencioni per mbrojtjen e mjedisit të Kosovës
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
CDI	Community Development Initiative
ETC	European Training Consortium (Konzorciumi evropian i trajnimeve)
HIV	Human Immunodeficiency Virus
IEK	Informimi, edukimi, komunikimi.
IST	Infeksionet seksualisht të transmetueshme
KADC	Kosovo Advocacy and Development Centre
KESH	Komisioni i edukimit shëndetësor
KPSH	Kujdesi parësor shëndetësor
KDSH	Kujdesi dytësor shëndetësor
KTSH	Kujdesi tretësor shëndetësor
KKK	Kryqi i Kuq i Kosovës
MASHT	Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë
MDG	Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit (Millenium Development Goals)
MKRS	Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OJQ	Organizatat Jo-Qeveritare
OQ	Organizatat Qeveritare
QKUK	Qendra Klinike Universitare e Kosovës



QMG	Qendra për Mirëqenien e Gruas
UA	Udhëzimi administrativ
UNFPA	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullatë
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë
WB	Banka Botërore
ZhVP	Zhvillimi i Vazhdueshëm Profesional

## **FJALA E MINISTRIT**

Edukimi dhe promovimi shëndetësor është thelbësor për të parandaluar sëmundjet dhe për të ndihmuar qytetarët që të jenë të shëndetshëm dhe të gëzojnë mirëqenie të plotë. Me qëllim të ruajtjes dhe përparimit të shëndetit, që është prioriteti kryesor në dokumentet tona strategjike, Ministria e Shëndetësisë ka hartuar Planin për Promovim dhe Edukim Shëndetësor 2023-2025, përmes së cilit synon të zhvillojë një qasje të integruar që do të ndihmojë në parandalimin e sëmundjeve dhe uljen e kostos së shëndetit në të ardhmen.

Ky plan synon që të nxis aktivitete konkrete nga ana e institucioneve, për ta përgatitur popullatën për të bashkëvepruar për mbrotjen e shëndetit, për të rritur aftësitë e saj për të reaguar ndaj rreziqeve, menaxhuar dhe përmirësuar shëndetin përmes parandalimit dhe pjesëmarrjes së drejtpërdrejt në vendimmarrje dhe në ruajtjen e shëndetit, në vende të punës, në shkolla, në komunitet dhe në mjediset e kujdesit shëndetësor.

Përmes pesë objektivave specifike, ky plan përfshin veprime për nxitjen e sjelljeve të shëndetshme, rritjen e aktivitetit fizik në mesin e popullatës, promovimin e të ushqyerit të shëndetshëm, ngritjen e ndërgjegjësimit për të luftuar konsumimin e duhanit e alkoolit, promovimin e shëndetit të nënës dhe fëmijës, vizitave shtëpiake dhe aktiviteteve që parandalojnë sëmundjet ngjitëse dhe jo ngjitëse kronike si dhe parandalimin e komplikimeve. Duke njohur rëndësinë e pjesëmarrjes së të gjithëve në ruajtjen dhe përparimin e shëndetit, Plani parashikon ngritjen e mekanizmave të ri për Promovim dhe Edukim Shëndetësor si dhe atyre për dëgjim social dhe dialog, për të adresuar shqetësimet e popullatës lidhur me shëndetin.

Promovimi dhe edukimi shëndetësor do të realizohet përmes formave të ndryshme të informimit e komunikimit, përfshirë mënyrat tradicionale të komunikimit dhe duke përdorur e integruar gjithashtu platforma të reja të komunikimit si podcast-ët e ndryshëm, përdorimin masiv të mediave/rrezeve sociale , zhvillimin e aplikacioneve mobile dhe digjitale.

Në të gjitha këto, aktivitete, të cilat do të zhvillohen nga institucionet në partneritet me hisedarët e tjerë, rol vendimtar do të këtë inkuadrimit i individit, familjes dhe komunitetit në zbatimin e këtij plani.

Si Ministër i Shëndetësisë i inkurajoj të gjithë për bashkëpunim në zbatimin e këtij plani, i bindur se ky do të jetë një dokument i përshtatshëm dhe i mundshëm për zbatim për arritjen e qëllimit tonë që është ndërtimi i një shoqërie sa më të shëndetshme dhe më të qëndrueshme në të ardhmen.

**Dr. Arben Vitia, Ministër i Shëndetësisë**

## 1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ministria e Shëndetësisë ka përcaktuar ruajtjen dhe përparimin e shëndetit si një nga objektivat strategjike në kuadër të politikave të saja shëndetësore. Në funksion të arritjes së këtij objektivi është hartuar Plani për Promovim dhe Edukim Shëndetësor 2023-2025, i cili synon promovimin e mënyrës së shëndetshme të jetesës dhe krijimin e shprehive të cilat ndikojnë në ruajtjen dhe përmirësimin e shëndetit të popullatës dhe mirëqenies së saj.

Plani fuqizon bashkëpunimin ndërsektorial dhe të gjithë hisedarëve që janë përgjegjës për shëndetin e popullatës, duke inkuadruar e vendosur në qendër individin dhe komunitetin, përgjatë gjithë ciklit jetësor me synim informimin, promovimin, edukimin dhe komunikimin, për të përmirësuar gjendjen shëndetësore dhe cilësinë e jetës dhe uljen e kostos së shëndetit në të ardhmen.

Qëllimet e planit janë që të bëhet ngritja e vetëdijesimit dhe edukimit të popullatës në lidhje me faktorët e rrezikut të sëmundjeve dhe mënyrat për t'i shmangur ato; zhvillimin e një kulture shëndetësore që promovon aktivitetin fizik, ushqimin e shëndetëshëm; reduktimin e përdorimit dhe pasojat negative të pirjes së duhanit, drogave dhe pijeve alkoolike; promovimin e diagnostikimit dhe trajtimit të hershëm të sëmundjeve për të parandaluar përkeqësimin dhe komplikimet; dhe për të shmangur shpenzimet e panevojshme shëndetësore.

Këto qëllime do të arrihen përmes pesë objektivave specifike:

- Fuqizimi i bashkëpunimit ndërsektorial me qëllim të përmirësimit të shëndetit dhe mirëqenies si dhe adresimit të përcaktuesve socialë të shëndetit;
- Ngritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore, financimit, llogaridhënies dhe informimit me qëllim të ndërtimit të sistemeve të përshtatshme për promovimin e shëndetit;
- Përfshirja e individit, komunitetit-bashkësisë dhe popullatës në promovim dhe edukim shëndetësor;
- Promovimi dhe edukimi shëndetësor për pacientë dhe familje me qëllim të parandalimit të sëmundjes, menaxhimit të sëmundjes, parandalimit të komplikimeve; dhe
- Zhvillimi i materialeve dhe platformave të përshtatshme mediale për promovim dhe edukim shëndetësor.

Duke qenë që shëndeti është çështje komplekse, shpesh e përcaktuar nga faktorë që nuk varen vetëm nga sektori shëndetësor, i cili do ta ketë rolin kyç dhe drejtues në zbatimin e këtij plani, sektorë të tjerë do të përfshihen, gjithashtu, përmes aktiviteteve konkrete në zbatimin e këtij plani.

Zbatimi do të arrihet duke fuqizuar bashkëpunimin ndërsektorial përmes mekanizmave të përbashkët si Komisioni për Promovim dhe Edukim Shëndetësor; inkuadrimin e komunitetit në kujdesin për shëndetin dhe krijimin e mundësive për të rritur kontrollin dhe për të

përmirësuar shëndetin; trajnimin e personelit shëndetësor dhe jo-shëndetësor për promovim dhe edukim shëndetësor, edukimi shëndetësor për pacientët dhe anëtarët e familjes, krijimin e ekipeve mbështetëse për pacientët me qëllim të shmangies së komplikimeve të sëmundjeve; hartimin dhe shpërndarjen e materialeve të promovimit dhe edukimit shëndetësor; krijimin e Grupit ndërsektorial për dëgjim social; adresimin e çështjeve të shëndetit oral, shëndetit seksual, shëndetit të nënës dhe fëmijës, shëndetit të grupeve vulnerable, sëmundjeve ngjitëse dhe jo ngjitëse dhe edukimin për parandalimin dhe trajtimin e tyre; krijimin e platformave të reja për edukim dhe promovim shëndetësor; shfrytëzimin e rrjeteve sociale dhe mediave tradicionale, bashkëpunimin me shoqërinë civile dhe mediat. Plani përcakton bartësit e këtyre aktiviteteve, institucionet mbështetëse, koston financiare të tyre dhe afatet e realizimit, bazuar në treguesit e përcaktuar.

Veçori kryesore e Planit strategjik për promovim dhe edukimit shëndetësor është se ai vë në qendër të saj individin dhe komunitetin si dhe përkrahjen e tij nga institucionet me qëllim të përgatitjes për të shmangur rreziqet për shëndetin, reagimin efektiv ndaj këtyre rreziqeve, dhe nxitjen e një qasjeje aktive në parandalimin e sëmundjeve dhe përmirësimin e shëndetit.

Zbatimi i planit do të ketë edhe sfidat e tij, prandaj krijimi i mekanizmave për koordinim efektiv ndërmjet institucioneve shëndetësore dhe jo-shëndetësore do të ndihmojë në suksesin e zbatimit të tij dhe sigurimin e rezultateve të qëndrueshme.

Në plan janë parashikuar aktivitetet dhe buxheti për tre vjet (nga buxheti dhe kontributi i hisedarëve e partnerëve), ndërsa zbatimi i tij do të kërkojë koordinim dhe bashkëpunim nga të gjithë pjesëmarrësit në zbatimin e tij, përmes një procesi aktiv të monitorimit e vlerësimit të rezultateve të tij.

## 2. HYRJE

Shëndeti është çështje komplekse, shpesh e përcaktuar nga faktorë që nuk varen vetëm nga sektori shëndetësor. Në shëndet ndikojnë faktorët gjenetik, të stilit të jetës, faktorët që vijnë nga rrethi i ngushtë dhe i gjerë shoqëror dhe faktorët që vijnë nga organizimi i sistemit shëndetësor<sup>1</sup>.

Referuar Organizatës Botërore të Shëndetësisë, promovimi është procesi i aftësive të bëra për të rritur kontrollin mbi shëndetin, si dhe për ta bërë atë (shëndetin). Ai shkon përtej fokusit vetëm në ndryshimet individuale po drejt një loje të gjërë të shëndetit social dhe mjedisor.

Ky plan i ri i Veprimi për Promovimin e Shëndetësisë së synon të rinovojë promocionin e mbrojtjes dhe teknikës së mbrojtjes, politikës së adresuar sfidat e lojtarëve, në mënyrë që të shkëlqejë dhe të zvogëlojë pabarazitë e tyre të popullsisë kosovare në kuadrin e Axhendës 2030.

Duke u nisur nga faktorët që ndikojnë në shëndetin e popullatës dhe rreziqet potenciale ky plan strategjik është dizajnuar për të adresuar aktivitetet që kanë të bëjnë me:

Fuqizimin e bashkëpunimit në mes të partnerëve dhe sektorëve përfshirë shoqërinë civile dhe sigurimin e koordinimit dhe lidhshimit si në nivelin kombëtar, rajonal dhe lokal ashtu edhe në shtrirjen horizontale, ngritja e përgjegjësisë multisektoriale dhe qasjes gjithëpërfshirëse për shëndet në të gjitha politikatat, shëndet për të gjithë, dhe të gjithë për shëndet, me qëllim të përmirësimit të shëndetit dhe mirëqenies si dhe adresimit të përcaktuesve socialë të shëndetit.

Zhvillimin e qëndrueshmërisë përmes ngritjes së burimeve njerëzore, financimit, llogaridhënies dhe rrjedhës së informimit dhe raportimit me qëllim të ndërtimit të sistemeve të përshtatshme të promovimit të shëndetit.

Përfshirjen e individit, komunitetit-bashkësisë dhe popullatës në promovim dhe edukim shëndetësor me theks të vecantë te ata me shprehi higjienike joadekuate, me mungesë të kushteve të mirëfillta dhe infrastrukturës higjieniko-sanitare, përmes Informimit, edukimit dhe komunikimit shëndetësor.

---

<sup>1</sup> Lalonde Report Published in Canada in 1974



Edukimin shëndetësor në uljen e konsumimit të duhanit, alkoolit, ushqimit jo të shëndetshëm dhe rritja e aktivitetit fizik, ndikojnë në uljen e prevalencës dhe incidencës së sëmundjeve jo ngjitëse, kështu një theks i vecantë i kushtohet edukimit shëndetësor për pacientë dhe familje me qëllim të menaxhimit të sëmundjes, parandalimit të komplikimeve dhe rehabilitimi.

Adresimin e lëndimeve dhe traumatve në veçanti ato të lidhura me trafikun rrugor, ku shifrat e vdekshmërisë janë pothuajse dy herë më të larta se në vitet e kaluara si pasojë e konsumimit të alkoolit dhe drogës midis adoleshentëve.

Zhvillimin e platformave të përshtatshme mediale për promovim dhe edukim shëndetësor për të targetuar grupet vulnerable me theks te vecante për shëndetin seksual dhe riprodhues si dhe rreziqet për të fituar IST, përfshirë HIV infeksionin, Hepatitin B.

Bazuar në në objektiven e dytë të Strategjinë Sektoriale për Shëndetësi 2023-2030, prioritet konsiderohet ruajtja dhe përparimi i shëndetit të popullatës së Kosovës që ndërlidhet përveç tjerash me promovimin e jetesës së shëndetshme. Për zbatimin e suksesshëm të këtij plani strategjik kërkohet angazhim, financim i qëndrueshëm, përkrahje dhe pjesëmarrje aktive nga politikëbërësit, vendimmarrësit, institucionet relevante, individët si dhe komuniteti.

Qëllimi i dokumentit është orientimi i qasjes rreth një mjedisi të përshtatshëm dhe kushteve që çojnë në ruajtjen dhe përparimin e gjendjes shëndetësore, uljen e sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë, përmes aftësisë së popullatës që të rris përgjegjësinë dhe kontrollin për shëndetin e tyre dhe shfrytëzimin racional të shërbimeve shëndetësore e që rezulton me mirëqenien e qytetarëve. Në këto korniza do të synohet edhe përmirësimi i shërbimeve shëndetësore, me rritje të cilësisë së shërbimeve dhe informim për mënyrën e qasjes në këto shërbime.

Ky dokument bazohet në parimet themelore të promovimit shëndetësor sipas OBSH-së:

**Fuqizimi** - Iniciativat e promovimit shëndetësor duhet të mundësojë individët dhe bashkësisë për të marrë më shumë kontroll mbi faktorët personal, socio-ekonomik dhe mjedisor që ndikojnë në shëndetin e tyre.

**Pjesëmarrja aktive** - iniciativat e promovimit shëndetësor duhet të përfshijë në të gjitha fazat e planifikimit në mënyrë aktive ata që janë të interesuar për promovim shëndetësor,

**Qasja gjithëpërfshirëse**- Iniciativat e promovimit shëndetësor me qasje të tillë nënkuptojnë qasjen gjithëpërfshirëse të njeriut duke nxitur shëndetin fizik, mendor, shoqëror dhe shpirtëror.

**Qasja ndërsektorale** - duhet të përfshijë bashkëpunimin e agjencive nga sektorët relevant.

**Barazia dhe të drejtat njerëzore** - Iniciativat duhet të udhëhiqen nga një shqetësim për barazi dhe drejtësi sociale.

**Qëndrueshmëria** - Iniciativat e filluar dhe të zbatuara duhet të jenë të afta që të mbijetojnë edhe në rast se do të ndërpritet financimi i mëparshëm.

**Qasja multistrategjike** - Iniciativat për promovimin e shëndetit duhet të përdorin një shumëllojshmëri të metodave në kombinim me njëra tjetrën, duke përfshirë edhe zhvillimin e politikave, ndryshimeve organizative, zhvillimin e bashkësisë, legjislacionin, avokimin, edukimin dhe komunikimin.

**Informimi i bazuar në evidencë** - Ushtrimi i veprimtarisë së promovimit të shëndetit duhet të bëhet mbi bazën e evidencave të niveleve të larta dhe, nga ana tjetër, duhet të synojë ndërtimin e bazës së të dhënave përmes hulumtimeve kërkimore, monitorimit dhe vlerësimit të aktiviteteve. Dëshmia e efektivitetit të promovimit të shëndetit është e nevojshme për t'u demonstruar vendimmarrësve se promovimi i shëndetit funksionon dhe është një strategji efektive në shëndetin publik; të mbështesë profesionistët në zhvillimin dhe vlerësimin e projekteve; dhe për të informuar komunitetin e gjerë për përfitimet e veprimeve për promovimin e shëndetit<sup>2</sup>.

**Inovacioni** - Inovacioni për zhvillim ka të bëjë me identifikimin e zgjidhjeve më efektive për njerëzit e prekur nga sfidat e zhvillimit. Ai fokusohet në zbulimin e strategjive, qasjeve, njohurive dhe bashkëpunimeve të reja ose të përmirësuara që mund të përshpejtojnë veprimin e promovimit të shëndetit, veçanërisht për problemet komplekse sociale. Inovacionet mund të përfshijnë dimensione të tilla si lëvizjet sociale, inovacionet e lidhura me shërbimet, zgjidhjet dixhitale ose ndërmarrjet sociale, me ndryshime të shpejta ose në rritje. Për të arritur SDG-të, nevojitet investim i qëllimshëm dhe i llogaritur për të identifikuar, testuar dhe adoptuar qasje inovatore që do të katalizojnë ndryshimin<sup>3</sup>.

---

<sup>2</sup> Health Promotion in the Sustainable Development Goals (2018–2030)

<sup>3</sup> ibid

### 3. METODOLOGJIA

Plani Strategjik për promovim dhe edukim shëndetësor është hartuar sipas UA Nr. 07/2018<sup>4</sup> për planifikimin dhe hartimin e dokumenteve strategjike dhe planeve të veprimit, mbështetur në parimet themelore dhe etike të Ligjit për shëndetësi<sup>5</sup>, në parimet e promovimit shëndetësor sipas OBSH-së, udhërrëfyesve të UNICEF-it, UNFPA-së si dhe dokumenteve tjera relevante në fushën e promovimit dhe edukimit shëndetësor.

Plani është zhvilluar përmes procesit të konsultave të akterëve të sektorëve të ndryshëm duke përfshirë përfaqësues nga institucionet relevante të IKSHPK, MSh, MASHTI, MKRS, MMPHI, ShSKUK, QKMF si dhe këshilltarë dhe ekspertë vendor dhe ndërkombëtar, AQH, IHS, të cilët kanë përkrahur procesin e hartimit të dokumentit. Gjatë hartimit të dokumentit po ashtu janë konsultuar faktorë të shumtë vendim-marrës vendor dhe ndërkombëtar përfshirë strukturat profesionale dhe sektorin joqeveritar.

Gjatë procesit janë konsultuar dokumente të ndryshme si Strategjia Sektoriale e Shëndetësisë 2023-2030<sup>6</sup>, Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2023 - 2025<sup>7</sup>, Deklarata e Prioriteteve të Qeverisë 2023-2032<sup>8</sup> si dhe Marrëveshja e Stabilizim Asocimit e nënshkruar me Bashkimin Evropian, Shëndeti 2021<sup>9</sup>, Strategjia për Rininë 2019–2023<sup>10</sup> dhe dokumente tjera relevante.

Gjithashtu janë shfrytëzuar hulumtimet e realizuara si MICS 2019–2020<sup>11</sup>, Hulumtimi i shpejtë kualitativ për vulnerabilitetin specifik të komuniteteve Rom, Ashkali, Egjiptian në lidhje me HIV Infeksionin dhe AIDS -in në Kosovë<sup>12</sup>, GYTS 2016<sup>13</sup>, Njohuritë, qëndrimet dhe praktikat për mjedisin dhe shëndetin<sup>14</sup>, Nevojat për Ruajtjen e Shëndetit Mendor të Nxënësve, Strategjia Për Rininë 2019 – 2023, Strategjia për Shkollat Promovuese të Shëndetit në Kosovë 2009 – 2018<sup>15</sup>, Strategjia e Arsimit 2022-2026<sup>16</sup> me qëllim të identifikimit të çështjeve dhe sfidave prioritare lidhur me promovimin dhe edukimin shëndetësor në Kosovë. Aktivitetet tjetër i realizuar gjatë procesit

---

<sup>4</sup> UA Nr. 07/2018

<sup>5</sup> L 04/L-125, Ligji për shëndetësi, 2013

<sup>6</sup> MSh, Strategjia Sektoriale e Shëndetësisë 2023-2030

<sup>7</sup> Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2023 - 2025

<sup>8</sup> Deklarata e Prioriteteve të Qeverisë 2023-2032

<sup>9</sup> OBSH, Shëndeti 2021: Kuadri i Politikave Evropiane në Mbështetje të Masave të Qeverisë dhe Shoqërisë për Shëndetin dhe Mirëqenien.

<sup>10</sup> Strategjia Për Rininë 2019 – 2023, MKRS

<sup>11</sup> ASK, MICS 2019–2020

<sup>12</sup> Hulumtimi i shpejtë kualitativ për vulnerabilitetin specifik të komuniteteve Romë, Ashkali, Egjiptian në lidhje me HIV Infeksionin dhe AIDS -in në Kosovë

<sup>13</sup> GYTS 2016, IKSHPK, CDC

<sup>14</sup> Njohuritë, qëndrimet dhe praktikat për mjedisin dhe shëndetin

<sup>15</sup> Strategjia për Shkollat Promovuese të Shëndetit në Kosovë 2009 – 2018 Tetor 2009, Prishtinë, MASHTI

<sup>16</sup> Strategjia e arsimit 2022-2026, MASHTI



të hartimit të dokumentit ishte edhe shfrytëzimi i teknikës SWOT për definimin e objektivave dhe qasjen e pjesëmarrjes aktive të të gjithë akterëve.

Gjithashtu janë shfrytëzuar materiale dhe të dhëna të bazuara në dëshmi si: Analiza e gjendjes shëndetësore të popullatës 2020<sup>17</sup>, përfshirë analizën e performancës së institucioneve shëndetësore; Vlerësimi i Shërbimeve esenciale të shëndetit publik 2020<sup>18</sup>; Analiza e satisfaksionit të qytetarëve/pacientëve lidhur me shërbimet dhe njohuritë për sektorin shëndetësor, përfshirë edhe njohuritë për reformat e filluara në këtë sektor 2023<sup>19</sup>, studimet e fizibilitetit dhe të dhëna të tjera zyrtare nga Agjencioni i Statistikave të Kosovës, MSh dhe IKShPK.

#### 4. SFONDI

Kërkesat e popullatës për shërbime shëndetësore janë në rritje të vazhdueshme, andaj shpenzimet publike duhet t'iu përshtaten më tepër grupeve të interesit dhe popullatës për ruajtjen dhe përparimin e shëndetit të tyre, sidomos në fuqizimin e intervenimeve kosto-efektive për promovim dhe edukim shëndetësor.

##### 4.1. Konteksti ndërkombëtar

Karta e Otavës identifikon tri strategji themelore për promovimin shëndetësor<sup>20</sup>. Këto janë avokimi për shëndetin për të krijuar kushte themelore për shëndetin të indikuara më lart; dhënia e mundësive të gjithë njerëzve për të arritur potencialin e plotë shëndetësor; ndërhyrjen në interesat e ndryshme shoqërore në drejtim të përmirësimit të shëndetit. Kjo është rruga që mundëson dhe synon integrimin e të gjitha aktiviteteve drejtpërdrejtë për arritjen e barazisë në shëndet për gjithë popullatën.

Vizioni i *Planit Rajonal të Veprimit të propozuar për Promovimin e Shëndetit në Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (2018–2030) OBSH*<sup>21</sup>, është që “njerëzit më të shëndetshëm marrin vendime më të shëndetshme”. Katër qasje strategjike kryesore, të referuara kolektivisht si IVMF (MAPS), janë korniza për Planin e Veprimit:

---

<sup>17</sup> IKShPK, Analiza e gjendjes shëndetësore të popullatës 2020

<sup>18</sup> Vlerësimi i Shërbimeve esenciale të shëndetit publik 2020, IKShPK

<sup>19</sup> IKShPK, Analiza e kënaqsisl me sistem shëndetësor 2022

<sup>20</sup> WHO (1986). Ottawa Charter for Health Promotion. First International Conference on Health Promotion  
Ottawa. Geneva: World Health Organization. [http://www.who.int/hpr/nph/docs/ottawa\\_charter\\_hp.pdf](http://www.who.int/hpr/nph/docs/ottawa_charter_hp.pdf)

<sup>21</sup> OBSH, Planit Rajonal të Veprimit të propozuar për Promovimin e Shëndetit në Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (2018–2030)

1. Integrimi: Integrimi i promovimit të shëndetit dhe mjediseve të shëndetshme në zhvillim për arritjen e SDG-ve dhe alokimet buxhetore në përputhje me rrethanat.
2. Veprime më të shpejta: Zgjerimi i qëllimit dhe shtrirjes së promovimit të shëndetit, me fokus në përshpejtimin e veprimit aty ku nevoja është më e madhe, për të arritur barazi.
3. Mbështetja e politikave: Sigurimi i harmonizimit të politikave nëpër sektorë dhe nivele për të adresuar përcaktuesit e shëndetit dhe barazisë shëndetësore.
4. Forcimi i kapaciteteve: Rritja e burimeve njerëzore për promovimin e shëndetit, financimi i qëndrueshëm, përgjegjshmëria dhe sistemet e informacionit.

Deklarata e Jakartës për promovim shëndetësor sqaron rolin dhe rëndësinë e përcaktuesve të shëndetit duke ndërlidhur nivelet dhe sektorët<sup>22</sup>.

Deklarata e Alma-Ata-s<sup>23</sup> bënë thirrje për aksion në këto fronte:

- Ndërtimi i një politike të shëndoshë publike
- Riorientimi i shërbimeve shëndetësore
- Krijimi i ambienteve mbështetëse
- Fuqizimi i aksioneve të bashkësisë
- Zhvillimi i aftësive personale.

Qasja “Spitalet për Promovimin e Shëndetit” të OBSH-së synon të integrojë vlerat dhe standardet e promovimit të shëndetit në strukturën dhe kulturën e spitalit, duke përfituar pacientët, stafi dhe komuniteti. Promovimi i shëndetit duhet të jetë një pjesë qendrore e punës spitalore, duke përfshirë edukimin shëndetësor, parandalimin e sëmundjeve, shërbimet e rehabilitimit dhe fuqizimin e pacientëve, të afërmve dhe punonjësve. Për të përmbushur kërkesën në rritje për këto shërbime, spitalet duhet të zgjerojnë fushën e tyre dhe të ofrojnë aktivitete më sistematike, duke përfshirë edukimin terapeutik dhe këshillimin motivues, dhe të vënë një theks më të madh në kushtet e punës për të përmirësuar shëndetin, efikasitetin dhe cilësinë e kujdesit të personelit<sup>24</sup>.

---

<sup>22</sup> WHO (1997). Jakarta Declaration on Leading Health Promotion into the 21st Century. Geneva: World Health Organization. <http://www.who.int/healthpromotion/conferences/previous/jakarta/declaration/en>

<sup>23</sup> WHO/Europe | Publications – Declaration of Alma-Ata, 1978

<sup>24</sup> WHO, Standards for Health Promotion in Hospitals, 2004



Ndërhyrjet e vetë-kujdesit janë një mënyrë premtuese për të përmirësuar shëndetin dhe mirëqenien si nga perspektiva e sistemeve shëndetësore ashtu edhe për përdoruesit individualë. Ata kanë potencialin për të rritur zgjedhjen dhe autonominë kur janë të arritshme, të pranueshme dhe të përballueshme, duke promovuar vetëvendosje, vetë-efikasitet, autonomi dhe angazhim në shëndet për vetë pacientin dhe kujdestarët. Me udhëzimet e duhura dhe një mjedis mbështetës, ndërhyrjet e vetë-kujdesit inkurajojnë pjesëmarrjen aktive dhe mund të çojnë në rezultate të përmirësuara shëndetësore duke trajtuar aspekte të ndryshme të kujdesit shëndetësor. Për më tepër, ndërhyrjet e vetë-kujdesit janë komponentë kritikë në rrugën drejt arritjes së mbulimit shëndetësor universal, promovimit të shëndetit, dhe shërbimit ndaj grupeve të cenueshme, siç rekomandohet nga OBSH<sup>25</sup>.

Pasqyra e shëndetit të popullatës mund të prezantohet duke marrë në konsideratë shumë faktorë të cilët nuk varen vetëm nga sektori i shëndetësisë por janë rezultat i bashkërendimit të aktiviteteve e masave ndërsektoriale duke mundësuar që nën moton *'shëndeti në të gjitha politikat'* të sigurojnë *'shëndet për të gjithë'* dhe dhënien e potencialit të plotë të të gjithë qytetarëve të Kosovës me qëllim të rritjes së standardit jetësor, me moton *"të gjithë për shëndet"*.

Qasja multidisiplinare dhe ndërsektoriale "Shëndeti në të gjitha politikat", u bën thirrje të gjithë sektorëve që të marrin parasysh sistematikisht implikimet shëndetësore të politikave të tyre, kërkojnë përshtatje dhe shmangie të ndikimeve të dëmshme shëndetësore për të përmirësuar shëndetin e popullsisë dhe barazinë shëndetësore, me një themel të fortë të të drejtave të njeriut dhe drejtësisë sociale<sup>26</sup>.

One Health është një qasje bashkëpunuese, shumësektoriale dhe multidisiplinare – duke punuar në nivel lokal, rajonal, kombëtar dhe global – me qëllim të arritjes së rezultateve optimale shëndetësore duke njohur ndërlidhjen midis njerëzve, kafshëve, bimëve dhe mjedisit të tyre të përbashkët.

Shëndeti i planetit është një koncept që inkurajon politika të bazuara në prova për të promovuar shëndetin dhe prosperitetin e njeriut duke ruajtur mjedisin që na lejon të përparojmë.

---

<sup>25</sup> WHO, Guideline on self-care interventions for health and well-being, 2022 revision: executive summary

<sup>26</sup> PAHO, Strategy and plan of action on health promotion within the context of the sustainable development goals 2019-2030

## 4.2. Konteksti vendor

### Karakteristikat demografike, faktorët socio-ekonomik dhe mjedisor

Republika e Kosovës ka sipërfaqe prej 10,905.25 km<sup>2</sup>. Gjendet në pjesën e Evropës juglindore, e kufizuar me Shqipërinë në jug-perëndim, Malin e Zi në veri-perëndim, Serbinë në veri-lindje dhe në jug me Maqedoninë. Territori i Republikës së Kosovës karakterizohet me lartësi të ndryshme mbidetare. Pika më e ulët e Kosovës ndodhet në luginën e lumit Drini i Bardhë, në kufi me Shqipërinë dhe arrin lartësinë 270 m mbi nivelin e detit, e ajo më e lartë ndodhet në perëndim të Kosovës, në Gjeravicë – 2,656 m<sup>27</sup>.

Kosova, sipas regjistrimit të fundit në vitin 2011, ka popullsinë prej 1.78 milion banorësh<sup>28</sup>. Përqindja e popullsisë sipas grup moshave është si vijon: grup mosha 0-14 vjeç 24%, 15-64 vjeç 67% dhe mbi 65 vjeç 9%, që do të thotë se Kosova ka përqindje më të lartë popullatën produktive. Mosha mesatare e popullsisë së Kosovës është 30.2 vite. Jetëgjatësia mesatare në Kosovë për vitin 2020 është vlerësuar të jetë 76.7 vite, për meshkuj 74.1 vite, kurse për femra 79.4 vite<sup>29</sup>. Aktualisht në Kosovë janë 38 komuna me 1,469 vendbanime të organizuara sipas ligjeve të vendit <sup>30</sup>.

Gjatë vitit 2021, BPV reale shënoi rritje dyshifrore të paprecedentë prej 10.7% ndërsa ajo nominale rreth 17.5%<sup>31</sup>. Komponentët (nga ana e metodës së shpenzimeve të BPV-së) që kontribuuan në këtë rritje ekonomike reale të kënaqshme ishin konsumi total (veçanërisht ai privat) dhe eksporti total (veçanërisht eksporti i shërbimeve).

## 4.3. Roli dhe ndikimi i edukimit në shëndet dhe mbrojtje shëndetësore

Edukimi luan rol të rëndësishëm në të gjithë sektorët për të zhvilluar shkathhtësitë e udhëheqjes me situata në të cilat individit dhe komuniteti kalojnë gjatë jetës. Niveli i ultë i shkollimit gjithashtu kufizon qasjen në informata dhe shfrytëzimin e shërbimeve shëndetësore. Grupet e popullatës me kushte jo të mira socio-ekonomike kanë vështirësi në vazhdimin e shkollimit qoftë atë formal ose informal e me këtë edhe reflektim në gjendjen e tyre shëndetësore.

---

<sup>28</sup> ASK, vlerësim i popullatës

<sup>29</sup> ASK, Kosova në shifra 2020

<sup>30</sup> AKS, Zyra e Regjistrimit të Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave, 2011

<sup>31</sup> ASK 2021

Të dhënat tregojnë se gjysma e popullatës së rritur kanë kryer arsimin fillor ndërsa 4.18% të moshës mbi 15 vjeçare janë analfabetë, te femrat kjo shkallë është 5.07%. Shkalla e regjistrimit në shkollë fillore është 98.92% në vitin shkollor 2015/16 dhe shkalla e analfabetizmit është zvogëluar për 0.5% <sup>32</sup>.

MASHTI në kuadër të Kornizës së Kurrikulës, gjegjësisht në kompetencat që parasheh kurrikula ka përfshirë edhe kompetencën “Individ i shëndoshë” e cila përfshinë dhe çështjet e edukatës seksuale dhe shëndetit riprodhues.

Për të lehtësuar punën e mësimdhënësve UNFPA ka përkrahë MASHTInë hartimin e materialeve shtesë për fushën e edukimit seksual duke hartuar doracak ndihmës për mësimdhënës, bazuar në dokumentet kurrikulare dhe standardet për edukimin seksual në Evropë për tre nivelet e arsimit fillor, arsimit mesëm të ulët dhe arsimit të mesëm të lartë. Janë realizuar 12 video për 12 klasë. Është realizuar broshura për prindër si dhe doracaku për fëmijët me nevoja të veçanta. Janë mbajtur trajnime me mësimdhënës bazuar në lëndët që trajtojnë shëndetin seksual riprodhues në bashkëpunim me OJQ KOPF ( Fondi për popullsi i Kosovës), deri në vitin 2022 janë mbajtur gjithsej 2400 trajnime.

Nga hulumtimi i fundit i MICS (2019–2020), shumica e fëmijëve në Kosovë kanë përfunduar shkollën fillore (98%) dhe të mesme të ulët (96%) me pjesëmarrje të ngjajshme sipas gjinisë (1.01 djem dhe 1.00 vajza), kurse shkollën mesme të lartë e kanë përfunduar 84%, me mbizotërim të vajzave (1.08). Në përgjithësi, shkalla e vijueshmërisë për të tri nivelet është më e lartë në zonat rurale dhe nga familjet me standard më të lartë ekonomik<sup>33</sup>.

Sfidë e veçantë vazhdon të mbetet zbatimi i Ligjit për kontrollin e duhanit, edhe pse të dhënat nga hulumtimi GYTS i realizuar në vitin 2004 dhe i përsëritur në vitin 2016 tregojnë rënie të duhanpirjes në mesin e nxënësve të moshës 13-15 vjeçare, pas hyrjes në fuqi të Ligjit të duhanit<sup>34</sup>.

Gjatë vitit 2020-2022 Departamenti i Mjekësisë Sociale është përfshirë në të gjitha aktivitetet për kontrollin dhe menaxhimin e Pandemisë Covid-19. Fokusi kryesor i DMS ka qenë në prezentimin e aktiviteteve të IKShPK dhe MSh të ndërlidhura me procesin e vaksinimit kundër COVID-19 dhe masat e ndërmarra nga Qeveria kundër COVID-19.

Sa i përket informimit, edukimit, komunikimit dhe vetëdijësimin përfshirë vaksinimin janë zhvilluar fushatat senzibilizuese për popullatën dhe institucionet.

---

<sup>32</sup> ASK, MASHT: „Raporti vjetor statistikor me tregues arsimor 2015/16“

<sup>33</sup> Anketa e Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë në Republikën e Kosovës (MICS) 2019-2020, ASK;

<sup>34</sup> IKShPK, Global Youth Tobacco Survey 2004 dhe 2016

Aktivitetet kryesore mund të përmbledhen si më poshtë: pesëmarrje aktive në Komitetin e sëmundjeve ngjitëse në IKShPK dhe Task Team dhe në Qendrën Emergjente Operative në IKShPK; kujdestaritë në Qendrën e thirrjeve për Koronavirus, në ekipet kujdestare të Institutit për Karantinën në Qendrën e Studentëve; për kontrollën epidemiologjike të udhëtarëve në Aeroportin e Prishtinës dhe institucionet tjera sipas kërkesës; kontaktimi i rasteve që testohen si dhe kontaktet e kontakteve, që janë në vetizolim dhe futja e të dhënave të tyre në sistemin elektronik; takimet me drejtorët e shkollave, inspektorët dhe DKA e drejtorët e shkollave për rifillimin e mësimin në shkollimin parauniversitar dhe pjesëmarrja në përgatitjen e Udhëzuesve për strategjitë e kthimit në Institucione dhe me MASHTI për Udhëzuesin e rifillimit të mësimin në institucione parauniversitare; vlerësimi dhe komentimi i dokumentit “Organizimi i procesit mësimor në qendrat burimore për vitin shkollor 2020/2021” në Kosovë si dhe materialeve tjera të dërguara nga MASHTI si dhe “Udhëzime për Institucione shëndetësore se si të menaxhohet veprimtaria gjatë Pandemisë COVID-19”; përgatitja, dizajnimi dhe distribuimi i posterëve të Koronavirusit në Institucionet shëndetësore dhe arsimore në ato publike dhe private dhe ligjëratave për Koronavirusin për punëtorët shëndetësor, përgatitja e posterit për shkolla dhe institucione tjera; organizimi dhe implementimi i fushatës kundër COVID-19 “BASHKË” nga UNFPA. Pjesëmarrje në emisione në media e xhirime të spoteve TV me porosi edukativo shëndetësore për COVID-19 si dhe aktivitete për përkrahje të shëndetit mendor; Pjesëmarrja në Hulumtimin seroepidemiologjik të bazuar në popullatë sipas moshës për infeksionin SARS CoV-2 në Kosovë dhe pjesëmarrja në punëtorinë “Intra Action Review” organizuar nga OBSH për vlerësimin e shëndetit publik gjatë pandemisë; Puna e vazhdueshme dhe koordinimi me Grupin Punues për Udhëzuesit e sektorëve të ndryshëm në kuadër të vendosjes së masave të reja anti-COVID-19; Takime pune me MSh dhe UNICEF, OBSH për koordinimin e aktiviteteve për mobilizim social për vaksinim ndaj COVID-19.

HIV infeksioni dhe AIDS identifikohen si problem nga shumica e komuniteteve RAE, ku marrëdhënia seksuale është rrugë e vetme e bartjes së sëmundjes për shumicën e pjesëmarrësve, gjysma e respondentëve e cekin kondomin si masë mbrojtëse nga SST, por afër një e pesta e tyre nuk din asnjë metodë të mbrotjes. Në komunitetet RAE ekziston stigma ndaj personave të infektuar, pjesa dërmuese nuk i din qendrat e testimit, seksi komercial si dhe përdorimi i drogave janë dukuri prezente. Rekomandohet zhvillimi i politikave për gjithpërfshirjen sociale të grupeve të ndjeshme RAE, fuqizimi i fitimit të informatave për HIV infeksioni dhe AIDS, parandalimin dhe testimin për infeksionin, puna me media për programe dhe hulumtime në sferën e parandalimit, trajtimit dhe stigmës lidhur me HIV infeksioni dhe AIDS<sup>35</sup>.

Përmes projektit “Kujdes Shëndetësor i Qasshëm dhe Cilësor (AQH) në Kosovë që financohet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe zbatohet nga Swiss TPH, një komponentë e vecantë (Output 6) fokusohet në përmirësimin e edukimit shëndetësor të komuniteteve, familjeve dhe individëve; përmirësimin e sjelljeve shëndetësore të popullatës; dhe mbështeten e mobilizimit të komunitetit për aktivitetet e Promovimit/Edukimit Shëndetësor (PESH) në 20 komunat e projektit.

---

<sup>35</sup> IKShPK, CDF, Global Fund.: “Hulumtimi i shpejtë kualitativ për vulnerabilitetin specifik të komuniteteve Rom, Ashkalinj dhe Egjiptas në lidhje me HIV infeksionin dhe AIDS-in në Kosovë”, Prishtinë, Prill 2016



#### 4.4. Ndikimi i rrethit të ngushtë dhe të gjërë shoqëror në shëndet

##### Faktorët mjedisorë, banimi dhe cilësia e ujit

Faktorët e mjedisit mund të kenë ndikim shumë të rëndësishëm në shëndet<sup>36</sup>. Që nga viti 2003 janë aprovuar një sërë Ligjesh dhe aktesh nënligjore si dhe strategji sektoriale për Mbrojtjen e Mjedisit. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor e ka përpiluar strategjinë për Zhvillimin e Mjedisit në Kosovë.

Nga të dhënat që raportohen rregullisht nga institucionet që përcjellin gjendjen e mjedisit shifet se rreth 83% e popullatës së Kosovës furnizohet me ujë nëpërmjet të sistemeve publike të menaxhuara nga Kompanitë Rajonale të Ujit (KRU), kurse rreth 17 % furnizohen me ujë nga sistemet që nuk menaxhohen nga KRU ose sistemet vetanake, ndërkohë që rreth 0.7% e popullatës nuk janë të kyçura në sistemin e ujësjellësit. Përqindja e familjeve që janë duke përdorur burime të përmirësuara të ujit të pijshëm është 98.5%<sup>37</sup>. Një pjesë të madhe të popullatës, sidomos fëmijëve nën moshën 5 vjeçare, iu kanoset rreziku nga sëmundjet e ndryshme si rezultat i kontaminimit bakteror dhe atij kimik që përcillen nga uji i papastër.

Prodhimi i thëngjillit në Kosovë është rritur nga viti në vit. Në vitin 2006 janë prodhuar 6.5 milion ton, ndërsa në vitin 2013 janë prodhuar 8.2 milion ton thëngjill. Emetimet e pluhurit në Kosovë, në krahasim me limitet sipas kërkesës së Memorandumit të Athinës<sup>38</sup>, janë shumë të larta. Sipas Memorandumit për themelimin e Unionit Energjetik (Memorandumi i Athinës), i nënshkruar edhe nga Kosova (22 mars 2005), kërkesat e Direktivës 2001/80/EC duhet të përmbushen deri më 31 dhjetor 2017.

Sasia e mbeturinave të grumbulluara gjatë vitit 2019 është për 2.19 % më e madhe krahasuar me vitin e kaluar, kurse gjenerimi i mbeturinave që bazohet në sasinë e mbeturinave të grumbulluara në vitin 2019 është 269.18 kg/kokë banori/vit, sasi kjo më e vogël për 15.46 kg krahasuar me vitin paraprak<sup>39</sup>.

Mbulimin me shërbim të mbledhjes së mbeturinave komunale në vitin 2019 është 78.5%, krahasuar me vitin paraprak ka shënuar një rritje të vogël prej 2.9%.

---

<sup>36</sup> The Sundsvall Conference

<sup>37</sup> ZRRUK, Raporti i Zyres Rregullatore për Ujë dhe Kanalizim, 2014

<sup>38</sup> Memorandumi i Athinës për themelimin e Unionit Energjetik

<sup>39</sup> AMMK, Raporti për gjendjen e mbeturinave, 2020



Nga të dhënat e Raportit të AMMK<sup>40</sup>, vlerësohet se ajri në Kosovë nuk është i cilësisë së duhur dhe në disa lokalitete është tepër i ndotur nga aktivitete prodhuese (rrethina e KEK-ut, Feronikelit, Sharrcemit, ndotja nga trafiku, depozitat e mbetjeve urbane dhe industriale, etj.). Më së shumti ka tejkalime të vlerave të lejuara të pluhurit dhe grimcave të pluhurit PM10 dhe PM2.5<sup>0</sup>. Poashtu nga vjetari i statistikave shëndetësore më 2013, rezulton se sëmundjet e sistemit respirator prijnë në morbiditetin e përgjithshëm të sëmundjeve (rreth 27.4% të totalit të diagnozave)<sup>41</sup>.

Popullsia e rajonit të Ballkanit Perëndimor dhe të Evropës Lindore është e ekspozuar ndaj disa prej përqendrimeve më të larta të ndotjes së ajrit në Evropë, deri në pesë herë më të lartë se nivelet e udhëzuesve kombëtarë dhe të BE-së, dhe Udhëzuesin e OBSH-së për Cilësinë e Ajrit<sup>42</sup>.

Pavarësisht disa përmirësimeve në rajonin e Ballkanit Perëndimor, problemet e zakonshme - emetimet nga termocentralet (kryesisht me linjit) dhe impiantet prodhuese, ngrohja shtëpiake, trafiku dhe minierat janë ende ekzistuese. Energjia, industria, transporti, bujqësia, mbeturinat dhe konsumi i lëndëve djegëse të ngurta së bashku me kushtet e pafavorshme meteorologjike për shpërndarjen e ndotësve të emetuar në ajrin e ambientit, veçanërisht gjatë periudhës së dimrit (nëntor deri në janar), dhe krijimet e shpeshta të smogut në atë periudhë, janë identifikuar si faktorët kryesorë të ndotjes së ajrit të ambientit në vend.<sup>43</sup>

Për më tepër, sjellja dhe ndërgjegjësimi i njerëzve në vend për sa i përket ndotjes së ajrit nuk është mjaftueshëm e kënaqshme, siç thuhet në Anketën Evropiane të Cilësisë së Jetës dhe Anketën e Mozaikut të Kosovës. Më pak se 23% e popullsisë së Kosovës e përceptojnë cilësinë e ajrit të ambientit si të dobët dhe kjo është shumë më e lartë në mesin e popullatës së aglomeracionit të Prishtinës, veçanërisht Obiliqit, për shkak të afërsisë me termocentralet.<sup>44, 45, 46</sup>

## **Qasja në shërbime shëndetësore adekuate, cilësore dhe shfrytëzimi racional i tyre**

---

<sup>40</sup> AMMK, Raport Vjetor për Gjendjen e Mjedisit në Kosovë, AMMK Prishtinë 2017, Raporti për gjendjen e ajrit 2012

<sup>41</sup> IKShPK, Vjetari i Statistikave shëndetësore 2013,

<sup>42</sup> Banka Botërore. Raporti Rajonal mbi MCA i Ballkanit Perëndimor – MCA në Kosovë. 2019: <https://open.knowledge.worldbank.org/handle/10986/33041>

<sup>43</sup> MMPH, Raporti për Cilësinë e Ajrit për periudhën nëntor-dhjetor 2016 dhe janar 2017.

<sup>44</sup> OBSH, UNDP, Programi i Përbashkët i Vullnetarëve të OKB-së. Healthier Kosovo project (2017-2020).

<sup>45</sup> Eurofound. Anketa Evropiane e Cilësisë së Jetës. <https://www.eurofound.europa.eu/data/european-quality-of-life-survey>

<sup>46</sup> UNDP Kosovë. Mozaiku i Kosovës 2015. <http://asemblio.github.io/kosovo-mosaic-visualizer/en/index.html>

Edhe pse mundësitë për qasje në shërbime shëndetësore janë përmirësuar dukshëm gjatë viteve të fundit, ka grupe të popullatës të cilat ngelin në disavantazh sa i përket qasjes në shërbime shëndetësore edhe për shkak të nivelit të ultë të informimit, edukimit dhe komunikimit. Shërbimet shëndetësore në Kosovë ofrohen në tri nivele të kujdesit shëndetësor. Kujdesi parësor shëndetësor, i decentralizuar në nivel komune, ofrohet në Qendrat Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF), Qendrat e Mjekësisë Familjare (QMF), dhe Ambulancat e Mjekësisë Familjare (AMF). Kujdesi dytësor dhe tretësor shëndetësor nën organizimin e ShSKUK ofrohet nga Spitalet e Përgjithshme dhe klinikat e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) si i ofruesi më i madh i shërbimeve terciare. Shërbimet shëndetësore ofrohen edhe nga Qendra Klinike Universitare Stomatologjike në Kosovë (QKSUK), Qendra Kombëtare për Transfuzionin e Gjakut (QKTGJK), Instituti i Mjekësisë së Punës (IMPK) dhe Qendra e Mjekësisë Sportive (QMS). Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) zhvillon punën hulumtuese shkencore dhe organizon përkryerjen profesionale të punëtorëve shëndetësor si dhe është bazë arsimore e Fakultetit të Mjekësisë.

Rolin kryesor në promovim dhe edukim shëndetësor padyshim e kanë institucionet publike shëndetësore të nivelit parësor, por edhe ai dytësor dhe tretësor gjatë ofrimit të shërbimeve shëndetësore për pacientët, ofrojnë edhe shërbime edukative shëndetësore të cilat rezultojnë me promovim të shëndetit.

Akterë të rëndësishëm në sektorin e shëndetësisë janë ofruesit e shërbimeve shëndetësore përfshirë ofruesit privat të shërbimeve shëndetësore.

Në kuadër të promovimit të shëndetit në përgjithësi nevojitet përfshirja e Promovimit të shëndetit oral, duke marrë parasysh ndërlidhjen reciproke ndërmjet tyre. Parandalimi i sëmundjeve orale duhet të integrohen me programe parandaluese të sëmundjeve jo ngjitëse, që ndajnë faktorë të përbashkët rreziku dhe përcaktues socialë. Gjithashtu, integrimi i shërbimeve të shëndetit oral në kujdesin shëndetësor parësor është thelbësor për të ofruar akses më të barabartë në kujdesin gjithëpërfshirës.

Gjatë vitit 2020, në kujdesin parësor shëndetësor për vitin 2020 numri i banorëve në një mjek është 1,587. Shfrytëzimi i kapacitetit spitalor në nivel dytësor ishte 39.6%, kurse në QKUK ishte 49.7%. Zgjatja mesatare e mjekimit në spitalet e përgjithshme ishte 4.4 ditë, ndërsa në QKUK ishte 4.6 ditë. Në QKUK ishin 1,917 shtretër, janë kryer 9,652 operacione me 347,582 ditë mjekimi<sup>47</sup>. Sipas të dhënave të raportuara, gjatë dy dekadave të fundit, kemi rënie të lindshmërisë dhe vdekshmërisë së foshnjave <sup>48</sup>.

---

<sup>47</sup> IKShPK, Analiza e gjendjes shëndetësore të popullatës 2020

<sup>48</sup> Raporti i gjendjes perinatale në Kosovë, 2020, IKShPK

Shkalla e vdekshmërisë më e ulët se shtetet tjera rajonale dhe BE. Shkalla e fertilitetit 2.2 ‰ më e lartë se rajoni i BE 1.5‰. Në 2019 mortaliteti infantil është 8.7 ‰ dhe më i lartë se rajoni i BE 6,9‰ dhe vendet tjera rajonale. Në 2019 jetëgjatësia mesatare në lindje është vlerësuar të jetë 76,7 vite, vlerë kjo më e ulët më e ulëta në rajon dhe BE <sup>49</sup>.

Në vitin 2020 janë regjistruar gjithsej 157,849 raste me sëmundje infektive me Mb 8,638.70 në 100,000 banorë. Ky numër i sëmundjeve është më i ultë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2019 (198,940 raste të sëmundjes ose Mb 10,887.50 në 100,000 banorë).

Mbulimi me vaksinim për dozën e tretë të DiTePer është mbi 90%, ndërsa për MMR është 88%<sup>50</sup>.

Sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut bëjnë pjesë në tre diagnozat më e shpeshta në të tre nivelet. Ndër tumoret malinje, kanceri i gjirit është më i përhapuri me 22.3% dhe tumoret malinje të organeve të tretjes me 17.5%. Incidenca e kancerit për vitin 2019, është 155.2 për 100,000 banorë dhe më e ulët se në rajon dhe BE<sup>51</sup>.

Incidenca e TB është 34.4 në 100,000 banorë, krahasuar me rajonin e BE 11,47‰, më e ulët se në vendet e tjera në rajon dhe më e lartë se disa vendet Evropiane si Zvicra, Gjermania dhe Austria.

Shpenzimet e shëndetit publik prej shpenzimeve totale të qeverisë janë 7.75%, krahasuar me BE 15,75% më të ulëtat në rajon dhe Evropë.

Patologji tjetër me rëndësi që mund të parandalohet me promovim dhe edukim shëndetësor është Kariesi që vazhdon të mbetet sëmundja më e përhapur e njerëzimit sidomos te fëmijët.

Vlerësimi i shëndetit oral është bazuar në disa hulumtime jo-voluminoze të realizuara në vitin 2011 te moshat parashkollore (2-6 vjet) dhe shkollore (7-14), të cilat kanë treguar për një shkallë të lartë të prevalencës së kariesit, prej 91.2% te fëmijët parashkollorë dhe deri 94.4% te fëmijët e moshës shkollore. Te këta fëmijë është hasur për një shkallë të lartë të indeksit të kariesit të dhëmbëve, ku te fëmijët e moshës parashkollore janë gjetur mesatarisht 5.9 dhëmbë me karies, me mbushje apo të nxjerrur për shkak të kariesit. Po ashtu edhe te fëmijët e moshës dymbëdhjetë vjeçare është hasur në gjendje të njëjtë, me një mesatare prej 5.8<sup>52</sup>.

---

<sup>49</sup> IKShPK, Analiza e gjendjes shëndetësore të popullatës, 2020

<sup>50</sup> IKShPK, Buletini vjetor Departamenti Epidemiologjisë 2021

<sup>51</sup> IKShPK; Analiza e gjendjes shëndetësore të popullatës 2020.

<sup>52</sup> Agim Begzati, Kastriot Meqa, David Siegenthaler, Merita Berisha, Walter Mautsch. Dental Health Evaluation of Children in Kosovo. Eur J Dent 2011;5:32-39



### **Pabarazitë shëndetësore dhe ndërlidhja me papunësinë e të ardhurat e pamjaftueshme**

Dy të tretat e popullsisë në Kosovë janë popullsi në moshë pune ku përfshihet moshë 15-64 vjeçare. Në kuadër të popullsisë në moshë të punës, shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore është 39.3%. Shkalla e punësimit në Anketën e Fuqisë Punëtore, për vitin 2021 është 31.3%. Punësimi është më i lartë te meshkujt 45.9%, ndërsa te femrat është 16.5%. Femrat janë të punësuar kryesisht në sektorët e arsimit, tregtisë dhe kujdesit shëndetësor me 51.8% të tyre, ndërsa meshkujt janë kryesisht të punësuar në sektorët e tregtisë, ndërtimitarisë dhe prodhimit me 41.8%. Sektorët ekonomikë, që prijnë me punësim, vazhdojnë të jenë: tregtia me 16.8%; ndërtimtaria me 10.5%; prodhimi me 10.3%; dhe arsimit me 10.1%. Sa i përket të punësuarve me kontrata sipas ASK-së del se 43.5% e personave të punësuar kanë kontratë të përhershme në punën e tyre kryesore, ndërkohë që 56.5% kanë kontratë të përkohshme<sup>53</sup>. Shkalla e papunësisë për vitin 2021 ishte 20.7%<sup>54</sup>.

### **Varferia**

Popullata e Kosovës jeton në varfëri dhe të hyrat dhe burimet materiale, kulturore dhe sociale janë aq të pamjaftueshme dhe i pengojnë ata që të kenë standard jetësor të kënaqshëm. Si rezultat i të hyrave dhe burimeve të pamjaftueshme, njerëzit mund të jenë të përjashtuar apo të marginalizuar nga pjesëmarrja në aktivitetet të cilat në anën tjetër janë të zakonshme për njerëzit tjerë në bashkësi.

Është vlerësuar se 17.6% e popullsisë së Kosovës jeton nën kufirin e varfërisë, me 5.2 përqind të popullsisë nën kufirin e varfërisë së skajshme. Adresimi i varfërisë, të metave të edukimit, të ardhurave të pamjaftueshme është sfidë e veçantë për qeverinë për të ndikuar në ruajtjen dhe përmirësimin e shëndetit të qytetarëve. Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, në vitin 2015, 18 përqind e femrave në Kosovë jetojnë në varfëri në krahasim me 17.2 përqind të meshkujve<sup>55</sup>.

### **Orientimet drejt fuqizimit të promovimit dhe edukimit shëndetësor në Kosovë - Rrjeti i Komisioneve të promovimit dhe edukimit shëndetësor**

Promovimi dhe edukimi shëndetësor si proces tashmë aplikohet nga të gjitha nivelet e kujdesit shëndetësor të Kosovës nga profesionistë të trajnuar.

Njësia për promovim dhe edukim shëndetësorë në Departamentin e Mjekësisë Sociale të Institutit Kombëtarë të Shëndetësisë Publike të Kosovës, në bashkëpunim me institucione relevante shëndetësore dhe jo shëndetësore si dhe me OQ dhe OJQ vendore e ndërkombëtare, ka formuar Komisionin për edukim shëndetësor si njësi qendrore, multisektoriale në tetor të vitit 1999 për realizimin

<sup>53</sup> ASK, Anketa e Fuqisë Punëtore, 2021

<sup>54</sup> ASK, Statistikat e punës, 2021

<sup>55</sup> ASK, Banka Botërore Rajoni i Europës dhe Azisë Qendrore Praktika Globale për Varfërinë dhe Barazinë. „Varferia në konsum në Republikën e Kosovës në periudhën 2012-2015“

e veprimtarisë edukativo shëndetësore në Kosovë. Në vitin 2014 me vendim të Ministrit të Shëndetësisë është zyrtarizuar Komisioni për promovim dhe edukim shëndetësor në nivelin qendror i cili kryesohet nga përfaqësuesi i IKShPK, dhe anëtarë të këtij komisioni janë përfaqësues tjerë të IKShPK, të Qendrave Rajonale të Shëndetit Publik, përfaqësues të ministrive, të organizatave ndërkombëtare dhe përfaqësuesi i Kryqit të Kuq të Kosovës. Në nivelin rajonal është i organizuar komisioni për edukim shëndetësor që ka përfaqësues të të gjitha komunave të atij rajoni, ndërsa në nivel të komunës është komisioni komunal që përbëhet nga përfaqësuesit e QKMF-ve, përfaqësues të arsimit, përfaqësues të Kryqit të Kuq Komunal dhe përfaqësues të OJQ-ve që veprojnë në atë komunë por që nuk është funksional plotësisht në të gjitha komunat.

#### **4.5. Qasja multisektoriale**

Përfshirja e individëve dhe institucioneve vendore dhe ndërkombëtare kontribon në ngritjen e cilësisë së promovimit dhe edukimit shëndetësor.

Një nga prioritetet e sektorit të shëndetësisë për popullatën kosovare, është edhe shëndeti i të rinjve, sidomos atyre të moshës shkollore. Për të realizuar këtë sektori i arsimit, shëndetësisë, mjedisit dhe rinisë duke bashkëvepruar me organizatat qeveritare dhe joqeveritare dhe të gjithë të interesuarit me qëllim të edukimit, informimit dhe sigurimit të mundësive për të krijuar qëndrime të drejta lidhur me shëndetin dhe për të mësuar e zbatuar sjellje të shëndosha ka prezantuar një koncept të ri të njohur si shkolla promovuese të shëndetit. Ky koncept i përcaktuar në iniciativën e OBSH-së për shkolla promovuese të shëndetit si dhe atë të UNICEF-it ka për qëllim të ndërroj jo vetëm sjelljet e nxënësve, por edhe të personelit arsimor dhe mjedisit në të cilin këta nxënës jetojnë, mësojnë dhe punojnë. 'Shkolla Promovuese e Shëndetit' është përkufizuar si shkollë e shëndetshme, e efektshme dhe mbrojtëse, në të cilën përveç nxënësve përfshihen në mënyrë aktive edhe familja dhe bashkësia.

MASHTI luan rol të rëndësishëm në fushën e edukimit dhe promovimit shëndetësor, përmes zbatimit të konceptit të shkollave të shëndetshme ku përmes partneritetit ndërministror, ndihmon në sigurimin se ekspertiza prej ministrive tjera është përdorur për programet të cilat janë shumë sektoriale siç është edhe nisma e programit për shkollat promovuese të shëndetit. Duke zbatuar marrëveshjen e bashkëpunimit në mes të ministrive të linjes si MASHTI, MSh, MMPHI, të gjitha palët u pajtuan që të lidhin marrëveshje për të zhvilluar politika dhe siguruar bashkëpunim ndërministror në fushën e edukimit dhe promovimit shëndetësor, për të promovuar ambient të shëndoshë shkollor, ku nxënësit mund të përfitojnë njohuri dhe aftësi të reja dhe duke forcuar partneritetin ndërmjet shkollës, nxënësve, prindërve dhe komunitetit në mënyrë që të gjitha agjencionet të kenë rol pozitiv në mirëqenien e tyre.



MASHTI ka rolin e koordinimit të komitetit ndërministror duke siguruar përkrahje të koordinuar në aktivitetet e edukimit dhe promovimit shëndetësor përmes hartimit të kurrikulave, shkollore për edukim shëndetësor si dhe aktivitetëve tjera që i ndërmerr shkolla për të ruajtur shëndetin.

MSh-ja përmes ndikimit të saj në drejtoritë komunale të shëndetësisë, inspekcioneve sanitare do të përcjellë kualitetin e ujit të pijes në shkolla, kushtet higjieniko sanitare dhe çështjet e tjera që kanë të bëjnë me shëndetin në shkolla. Kjo arrihet përmes IKShPK-së në Prishtinë dhe departamenteve të shëndetit publik dhe qendrave të mjekësisë familjare.

MMPHI për programin për shkollat e shëndetshme do të sigurojë informim të vazhdueshëm për çështjet mjedisore, organizimin e aktivitetëve me karakter garues, ndihmë në rregullimin e oborreve shkollore duke ndihmuar edhe në projektimin e hapësirave mjedisore të shkollës.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Strategjinë e përpiluar për të rinjtë kosovar 2013-2017 si objektive strategjike e ka përfshirë edhe edukimin dhe promovimin shëndetësor të të rinjve si dhe ka përgatitur standardet për edukimin e bashkëmoshatarëve të cilat duhet të zbatohen me rastin e realizimit të aktivitetëve edukativo shëndetësorë në komunitetet përkatëse. Ndërsa, Strategjia për Rini 2019-2023, në mesin e tre objektivave strategjike kishte edhe objektiven: Mjedis i shëndetshëm dhe i sigurtë për të rinjtë. Në vitin 2022, MKRS<sup>56</sup> ka bërë vlerësim të realizimit të Strategjisë për Rini dhe të gjeturat nga vlerësimi janë: rritja e vazhdueshme e sjelljeve apo dukurive negative (duhanpirja, veçanërishtë ekspozimi në tym duhani në mjediset publike, konsumimi i drogave dhe alkoolit), si dhe temat për shëndetin seksual (përfshirë edhe sëmundjet seksualisht të transmetueshme), promovimin e jetës së shëndetshme në përgjithësi (promovimi i të ushqyerit shëndetshëm, aktivitetit fizik, etj.), dhunen fizike, bulizmi, dhe ngacnimet psiko-fizike.

### **Angazhimi proaktiv i bashkësisë**

Angazhimi proaktiv i bashkësisë bëhet përmes fushatave vetëdijesuese të cilat ofrojnë mbështetje efektive ndërsektoriale, me qëllim të ruajtjes dhe përmirësimit të popullatës përgjatë gjithë ciklit jetësor, duke siguruar barazi gjinore, përfshirje të popullatës me nevoja të veçanta si dhe të gjithë atyre që jetojnë në rrethana të ndryshme gjeografike, socio-ekonomike dhe kulturore.

Aktivitetet e organizatave joqeveritare janë përkrahur në vazhdimësi duke pasur parasyshë rolin e tyre në relacion me bashkësinë nga e cila ata derivojnë. Në aftësimin e anëtarësisë së tyre vullnetarët e Kryqit të Kuq të Kosovës, anëtarët e OJQ-ve që kanë prezantuar interesat e komuniteteve nacionale (Serb, Boshnjak, Turq, Rom, Ashkali, Egjiptian), moshore dhe gjinore (të rinjtë e OJQ-ve, grave, të

---

<sup>56</sup> MKRS, Raporti i vlerësimit të Strategjisë për rini 2019-2023, 2023

moshuarve), posaçërisht është punuar me dy programe të Kryqit të Kuq të Kosovës dhe atë me programin e edukimit shëndetësor në familje dhe atë të rinisë së KKK.

### **Ngritja e kapaciteteve**

Zhvillimit të qëndrueshëm profesional të kuadrit profesional të kësaj lëmie i është kushtuar një kujdes i veçantë. Në vitin 2006 është bërë organizimi i kursit të promovimit dhe edukimit shëndetësor në Universitetin Veror të Prishtinës, organizimi i takimit të parë kombëtar të promotorëve dhe edukatorëve shëndetësor në Prizren në vitin 2007 me rastin e Ditës Botërore të Shëndetit, me ç'rast është organizuar ekspozita e parë e edukimit shëndetësor e cila ka qenë e karakterit lëvizës duke i vizituar më pas të gjitha qendrat e mëdha në Kosovë. Është themeluar Asociacioni i promotorëve shëndetësor në vitin 2007 si organizatë joqeveritare e regjistruar në institucionet kompetente kosovare. Në vitin 2015 është mbajtur Konferenca e I-rë Rajonale "Promovimi dhe Edukimi Shëndetësor: Nga politika në praktikë, nga praktika në politikë", pjesëmarrja në shkollën verore të ETC: "Creating salutogenic environments", si dhe më vonë gjatë të njëjtit vit është organizuar punëtorja rajonale në bashkëpunim me Komisionin Evropian (TAIEX): "MultiBeneficiary Workshop on Participatory Action Research in Health Promotion and Education". Në vitin 2017, me 26 - 28 Tetor është organizuar Konferenca e II-të "Promovimi dhe Edukimi Shëndetësor: Mësimi nga përvoja", ndërsa Konferenca e III-të "Promovimi dhe Edukimi Shëndetësor: Mjediset e shëndetshme" është mbajtur në Prishtinë me 28 - 30 Shtator 2022 me pjesëmarrje rajonale dhe ndërkombëtare.

Edhe pse nuk ekziston fushë e ngushtë e specializimit për promovimin dhe edukimin shëndetësor por është pjesë integruese e programit të specializimit të mjekësisë sociale dhe shëndetësisë publike por edhe të shumë programeve tjera e sidomos të asaj të mjekësisë familjare nevojitet të dizajnohen programe të masterit për profilet e ndryshme që merren me promovim dhe edukim shëndetësor.

### **Zhvillimi i materialeve dhe angazhimi i mediave**

Janë zhvilluar dhe distribuuar një mori materialesh edukativo shëndetësore me përmbajtje cilësore bazuar në standardet ndërkombëtare dhe bazuar në literaturë<sup>57</sup>. Metodrat dhe mjetet të cilat përdoren në realizimin e aktiviteteve të promovimit dhe edukimit shëndetësor janë të sofistikuarra në krahasim me periudhat e mëparshme. OBSH, UNICEF, UNFPA - zyrat në Prishtinë dhe AQH janë organizatat të cilat në mënyrë të vazhdueshme ofrojnë mbështetje financiare dhe teknike në realizimin e disa programeve edukativo shëndetësore si dhe hulumtimeve të kësaj fushe, e sidomos në shtypjen e materialeve edukativo shëndetësore.

---

<sup>57</sup> Edukimi Shëndetësor, Ilir Begolli, 2002, Prishtinë

Me qëllim të transparencës si dhe të krijimit të mundësive për bashkëpunim më të thellë dhe aleancës kreative janë realizuar në kontinuitet relacionet shumë produktive me mediat gjë që edhe sot e në të ardhmen shpresojmë se do të vazhdon.

Sipas vendbanimit, dallimi është sinjifikant në mes të banesave me qasje në internet, telefon celular dhe tokësor për vendet urbane me standard më të lartë të jetesës <sup>58</sup>.

Mungesa e përkrahjes financiare dhe buxheti i veçantë për këtë veprimtari nga institucionet relevante, është faktor kyç pengues në realizimin e plotë të veprimtarisë edukativo shëndetësore.

## 5. TË GJETURAT NGA SWOT ANALIZA

Përparësitë	Mangësitë
<ul style="list-style-type: none"> <li>• KESh qendror dhe rajonal funksional</li> <li>• Plani strategjik dhe plani i veprimit</li> <li>• Përvoja në Promovim dhe edukim shëndetësor</li> <li>• Bashkëpunimi me Institucione qeveritare dhe jo qeveritare vendore dhe ndërkombëtare</li> <li>• Bashkëpunimi me Media</li> <li>• Përkrahja e donatorëve</li> <li>• Standardet për përpilimin e materialeve të promovimit dhe edukimit shëndetësor</li> <li>• Anëtar në IANPHI dhe ASPHER</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mungesa e linjës buxhetore të veçantë</li> <li>• Mungesa e personelit</li> <li>• Mungesa e drejtimit Master në Promovim dhe edukim shëndetësor</li> <li>• Mungesa e specializimeve dhe sub-specializimeve përkatëse</li> <li>• Moshimi i profesionistëve shëndetësor</li> <li>• Mungesa e koordinatorëve të ESh në nivel komunal</li> <li>• Mungesa e raportimit të rregullt të aktiviteteve të ESh</li> <li>•</li> </ul>

<sup>58</sup> Profili i Kosovës, IKShPK, 2015



<ul style="list-style-type: none"> <li>• Rrjeti i trajnerëve për Promovim dhe edukim shëndetësor</li> <li>• Infermierët e trajnuar për Intervistim motivues në edukim shëndetësor</li> </ul>	
<b>Mundësitë</b>	<b>Rreziqet</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Funksionalizimi dhe fuqizimi i koordinatorëve të KESH në nivel komunal</li> <li>• Zgjerimi i bashkëpunimit ndërkombëtar</li> <li>• Anëtarësimi në IUHPE</li> <li>• Vazhdimi i shfrytëzimit të profesionistëve të trajnuar në fusha specifike të ESh</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndërprerja e mundshme e bashkëpunimit ndërsektorial</li> <li>• Ndërprerja e mundshme e donacioneve</li> <li>• Migrimi i profesionistëve shëndetësor</li> <li>• Mungesa e qëndrueshmërisë së programeve të trajnimeve</li> <li>• Mungesa e stimujve për ekspertët e PESH</li> </ul>

Në vlerësimin e realizuar në vitin 2015, shumica e të anketuarve nga të gjitha strukturat e përfshira në anketim shprehnin pakënaqësinë me kushtet sociale ekonomike në vend. Të gjithë kanë ndarë mendimin se njerëzit më të lumtur janë ata të cilët kanë kushte të mira ekonomike, propozojnë se në përmirësimin e gjendjes shëndetësore aktuale nga ana e profesionistëve shëndetësorë do të ishte organizimi i mirë i burimeve njerëzore në shëndetësi, ndërsa kryesisht opinioni i qytetarëve është se qeveria është ajo e cila mund të ndikojë në përmirësimin e gjendjes shëndetësore në vend si dhe për ndryshim janë të motivuar shumica e më tepër. 65.5% janë mesatarisht të kënaqur me shërbimet shëndetësore, por vetëm 14.5% vlerësojnë se kanë ndikim në përmirësimin e gjendjes shëndetësore, 45.5% vlerësojnë se mesatarisht investohet në shërbimet shëndetësore dhe ato ekonomiko sociale, vetëm 12.7% janë deklaruar se shumë zhvillojnë aktivitete për përmirësimin e stilit të shëndoshë të jetës pa dallim sipas gjinisë<sup>59</sup>.

Prej problemeve më madhore vendimmarrësit e profesionistët identifikojnë papunësinë, infrastrukturën, gjendjen socioekonomike, shërbimet shëndetësore jocalësore, aerondotjen dhe kulturën shëndetësore.

<sup>59</sup> IKShPK, Profili i Prishtinës, 2015

Nga anketa e kënaqshmërisë me sistem shëndetësor<sup>60</sup> në vitin 2022 shumica e popullatës së intervistuar që e kanë shfrytëzuar kujdesin shëndetësor në 6 muajt e fundit (65%) është e kënaqur me shërbimet shëndetësore në Kosovë, ndërsa 2.6% i kanë vlerësuar shërbimet shëndetësore si të këqija dhe vetëm 1.7% si shumë të këqija. Përqindja më e lartë e atyre të cilët e kanë vlerësuar shërbimin si të shkëlqyeshëm kanë shfrytëzuar kujdesin parësor (20.1%) dhe spitalet publike. Arsye të pakënaqësisë me shërbime shëndetësore ishin pritjet e gjata, mungesa e barnave, shërbimi i pamjaftueshëm dhe komunikimi jo korrekt i personelit shëndetësor. Rekomandohet të punohen studime kualitative për të analizuar më thellë kënaqshmërinë e qytetarëve me shërbimet dhe sistemin shëndetësor.

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike (IKSHPK), Departamenti i Mjekësisë Sociale dhe Organizata Botërore e Shëndetësisë, Zyra në Prishtinë që nga 2020, kanë realizuar hulumtimin me titull: "Studimi intervent në Kosovë rreth njohurive, riskut, parandalimit dhe intervenimit gjatë pandemisë COVID-19" ("Behavioural Insights on COVID-19 in Kosovo: Monitoring knowledge, risk perceptions, preventive behaviours and trust to inform pandemic outbreak response"), me gjithsej gjashtë valë hulumtuese, për të siguruar evidenca mbi bazën e të cilave mund të dizajnohen masat adekuate për veprim nga ana e vendimmarrësve. Rekomandohet vazhdimi i realizimit të valëve tjera të hulumtimit të Behavioural Insights, duke qenë një burimi i rëndësishëm shtetëror për të dhëna të bazuara në evidenca dhe adresim të politik- bërjes mbështetur në të dhëna shkencore.

## 6. OBJEKTIVAT

Bazuar në vizionin e OBSH: "Njerëzit më të shëndetshëm marrin vendime më të shëndetshme", për të përmbushur misionin që të gjithë njerëzit, qeveritë dhe sektorët e ndryshëm të marrin pjesë në veprime për të arritur SZhQ (SDG) dhe të jenë më të informuar për vendimet që ndikojnë në shëndetin e të gjithëve, duhet krijuar sektorë, politika dhe mjedise promovuese të shëndetit sipas qëllimit të OBSH.

Bazuar në raportet e analizës së sektorit të shëndetësisë, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet rritjes së cilësisë dhe qasjes në shërbime shëndetësore dhe ruajtjes e përparimit të shëndetit të popullatës. Këto objektiva janë përcaktuar në Strategjinë Zhvillimore të Republikës së Kosovës 2023-2030 me të cilën janë vijëzuar edhe objektivat e Strategjisë Sektoriale të Shëndetësisë të Republikës së Kosovës për 2023-2030.

Bazuar në strukturën demografike të vendit, rëndësi të veçantë kanë promovimi dhe edukimi shëndetësor, duke ndikuar në krijimin e një kulture të shëndetit që në bashkëpunim me qytetarin promovon mënyrat e shëndetshme të jetesës dhe reduktimin e faktorëve të

---

<sup>60</sup> IKShPK, Analiza e kënaqshmërisë me shërbime shëndetësore 2022

rrezikut. Aktivitetet e parandalimit janë veçanërisht të rëndësishme për të ndihmuar ruajtjen dhe përparimin e shëndetit dhe Ministria e Shëndetësisë planifikon të ndër marrë hapa për të përmirësuar shëndetin e grupeve të ndieshme. Vëhet në pah gjithashtu nevoja për realizimin e hulumtimeve për të siguruar informim të bazuar në evidenca me qëllim lehtësimi të vendimmarrjes, si dhe informim në çdo nivel të shoqërisë përmes mjeteve të ndryshme të komunikimit, për të siguruar përkrahjen dhe bashkëpunimin e të gjithë hisedarëve në rritjen e kënaqshmërisë së qytetarëve me cilësinë, sigurinë dhe qasjen në shërbime shëndetësore. Ky Plan për promovim dhe edukim shëndetësor tenton që në mënyrë gjithpërfshirëse të adreson ruajtjen dhe përparimin e shëndetit si dhe rritjen e kënaqshmërisë së qytetarëve me cilësinë, sigurinë dhe qasjen në shërbime shëndetësore.

#### **Objektivat specifike:**

1. Fuqizimi i bashkëpunimit ndërsektorial me qëllim të përmirësimit të shëndetit dhe mirëqenies si dhe adresimit të përcaktuesve socialë të shëndetit.
2. Ngritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore, financimit, llogaridhënies dhe informimit me qëllim të ndërtimit të sistemeve të përshtatshme të promovimit të shëndetit.
3. Përfshirja e individit, komunitetit-bashkësisë dhe popullatës në promovim dhe edukim shëndetësor
4. Edukimi shëndetësor për pacientë dhe familje me qëllim të menaxhimit të sëmundjes, parandalimit të komplikimeve dhe rehabilitimi
5. Zhvillimi i materialeve dhe platformave të përshtatshme mediale për promovim dhe edukim shëndetësor.



## **7. ARANZHIMET E ZBATIMIT, MONITORIMIT DHE RAPORTIMIT**

Dokumenti është hartuar bazuar në Udhëzimin Administrativ nr. 07/2018 për planifikimin dhe hartimin e dokumenteve strategjike dhe planeve të veprimit. Në dokument janë definuar Objektivat strategjike, specifike dhe aktivitetet sipas afatit kohor të përcaktuar, institucionet përgjegjëse dhe mbështetëse për zbatim të aktiviteteve si dhe kostot financiare të zbatimit të aktiviteteve sipas viteve. Është Plan tre vjeçar me mundësi rishikimi çdo vit në kuadër të planifikimit të monitorimit.

Struktura për monitorimin e zbatimit të planit strategjik përbëhet nga treguesit e matjes të cilët janë vendosur në nivelin e objektivave specifike. Janë gjithsej 5 objektiva specifike. Monitorimi i progresit të zbatimit dhe arritjeve të planit strategjik do t'i komunikohet instancave përkatëse në baza të rregullta dhe kur është e nevojshme edhe publikut.

Për të monitoruar dhe vlerësuar zbatimin e planit strategjik të imunizimit janë identifikuar treguesit të cilët do të raportohen në mënyrë rutinore, tregues këta të cilët do të përfshihen edhe në kornizën e monitorimit dhe e vlerësimit të Strategjisë Sektoriale të Shëndetësisë 2017-2021.

Ky plan strategjik mund të shërbej si udhërrëfyes politik dhe profesional në zhvillimin e sektorit të shëndetësisë që ka për qëllim të ruaj dhe përparoj shëndetin e popullatës, përmes ofrimit të shërbimeve cilësore, gjithëpërfshirëse dhe kostoefektive për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.

Ministria e shëndetësisë dhe IKShPK janë bartëse të këtij plani 2023 - 2025 duke përfshirë vendimmarrësit dhe grupet e interesit që në veçanti kanë të bëjnë me promovim dhe edukim shëndetësor.

## 8. NDIKIMI BUXHETOR DHE ZBATIMI I PLANIT STRATEGJIK

Për zbatimin e aktiviteteve do të marrin pjesë të gjithë institucionet dhe grupet që janë konsultuar gjatë hartimit të dokumentit. MSh dhe IKShPK do të bëjnë vlerësimin lidhur me përfshirjen në edukim dhe promovim shëndetësor.

Bazuar në formularin e ndikimit financiar të dokumentit, Plani Strategjik për promovim dhe edukim shëndetësor 2023 - 2025 nuk do të krijoj kosto shtesë buxhetore, të gjitha aktivitetet të cilat dalin nga ky plan do të mbulohen nga ndarjet buxhetore të parapara në MSh, sipas planifikimeve buxhetore të përfshira në KASh 2023 - 2025.

Disa nga aktivitetet e përfshira në Plan do të financohen dhe implementohen nga komuniteti donatorë si OBSH, UNICEF, UNFPA, SDC/AQH, IHS, KADC, KOPF dhe partnerë tjerë.

Duke pasë parasysh karakteristikat demografike të popullatës, nevojat për buxhet shtesë për zbatim të aktiviteteve të këtij Plani do të jenë të domosdoshme, prandaj në kuadër të planifikimeve buxhetore të MSh-së për vitet në vijim promovimi dhe edukimi shëndetësor do të vazhdoj të jetë prioritet.

### Buxheti i planit të veprimit të PESH sipas Objektivave:

Objektiva strategjike	Buxheti	Koment
Objektiva specifike 1	€	
Objektiva specifike 2		
Objektiva specifike 3		
Objektiva specifike 4		
Objektiva specifike 5		
<b>Total buxheti</b>		

## 9. LITERATURA

- Agim Begzati, Kastriot Meqa, David Siegenthaler, Merita Berisha, Walter Mautsch. Dental Health Evaluation of Children in Kosovo. Eur J Dent 2011;5:32-39
- AMMK, Raporti për gjendjen e mbeturinave, 2020
- AMMK, Raport Vjetor për Gjendjen e Mjedisit në Kosovë, Prishtinë 2017
- Anketa e Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë në Republikën e Kosovës (MICS) 2019-2020; ASK 2021
- ASK, Anketa e Fuqisë Punëtore, 2021
- ASK, Banka Botërore Rajoni i Europës dhe Azisë Qendrore Praktika Globale për Varfërinë dhe Barazinë. „Varfëria në konsum në Republikën e Kosovës në periudhën 2012-2015“
- ASK, Kosova në shifra 2020
- ASK, MASHT: „Raporti vjetor statistikor me tregues arsimor 2015/16“
- ASK, Statistikat e punës, 2021
- ASK, vlerësim i popullsisë
- ASK, Zyra e Regjistrimit të Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave, 2011
- Banka Botërore. Raporti Rajonal mbi MCA i Ballkanit Perëndimor – MCA në Kosovë: 2019: <https://open.knowledge.worldbank.org/handle/10986/33041>
- Deklarata e Prioriteteve të Qeverisë 2023-2032
- Edukimi Shëndetësor, Ilir Begolli, 2002, Prishtinë
- Eurofound. Anketa Evropiane e Cilësisë së Jetës. <https://www.eurofound.europa.eu/data/european-quality-of-life-survey>
- GYTS 2016, IKShPK, CDC
- Health Promotion in the Sustainable Development Goals (2018–2030)
- IKShPK, Analiza e gjendjes shëndetësore të popullatës 2020
- IKShPK, Anketa e kënaqshmërisë me sistem shëndetësor 2022
- IKShPK, Buletini vjetor, Departamenti Epidemiologjisë, 2021.
- IKShPK, CDF, Global Fund.: “Hulumtimi i shpejtë kualitativ për vulnerabilitetin specifik të komuniteteve Romë, Ashkali, Egjiptian në lidhje me HIV infeksionin dhe AIDS-in në Kosovë”, Prishtinë, Prill 2016
- IKShPK, Global Youth Tobacco Survey 2004 dhe 2016
- IKShPK, Profili i Kosovës, 2015
- IKShPK, Profili i Prishtinës, 2015
- IKShPK, Raporti i gjendjes perinatale në Kosovë, 2020

IKShPK, Vjetari i Statistikave shëndetësore 2013  
Lalonde Report Published in Canada in 1974  
Ligji 04/L-125 për shëndetësi, 2013  
Memorandumi i Athinës për themelimin e Unionit Energjetik  
MKRS, Raporti i vlerësimit të Strategjisë për rini 2019-2023, 2023  
MMPH, Raporti për Cilësinë e Ajrit për periudhën nëntor-dhjetor 2016 dhe janar 2017.  
MSh, Strategjia Sektoriale e Shëndetësisë 2023-2030  
Njohuritë, qëndrimet dhe praktikët për mjedisin dhe shëndetin  
OBSh, UNDP, Programi i Përbashkët i Vullnetarëve të OKB-së. Healthier Kosovo project (2017-2020).  
PAHO, Strategy and plan of action on health promotion within the context of the sustainable development goals 2019-2030,  
Strategjia e arsimit 2022-2026, MASHTI  
Strategjia Për Rininë 2019-2023, MKRS  
Strategjia për Shkollat Promovuese të Shëndetit në Kosovë 2009-2018, Tetor 2009, Prishtinë, MASHTI  
Shëndeti 2021: Kuadri i Politikave Evropiane në Mbështetje të Masave të Qeverisë dhe Shoqërisë për Shëndetin dhe Mirëqenien.  
The Sundsvall Conference  
Udhëzimi Administrativ Nr. 07/2018  
UNDP Kosovë. Mozaiku i Kosovës 2015. <http://asemblio.github.io/kosovo-mosaic-visualizer/en/index.html>  
Vlerësimi i Shërbimeve esenciale të shëndetit publik 2020, IKSHPK  
WHO (1986). Ottawa Charter for Health Promotion. First International Conference on Health Promotion Ottawa. Geneva: World Health Organization. [http://www.who.int/hpr/nph/docs/ottawa\\_charter\\_hp.pdf](http://www.who.int/hpr/nph/docs/ottawa_charter_hp.pdf)  
WHO, Guideline on self-care interventions for health and well-being, 2022 revision: executive summary  
WHO, Standards for Health Promotion in Hospitals, 2004  
WHO/Europe | Publications – Declaration of Alma-Ata, 1978  
ZRRUK, Raporti i Zyres Rregullatore për Ujë dhe Kanalizim 2014



## PLANI I VEPRIMIT

Plani Strategjik për Promovim dhe Edukim Shëndetësor 2023 - 2025								
Objektiva strategjike: Ruajtja dhe përparimi i shëndetit përmes promovimit dhe edukimit shëndetësor								
Objektiva specifike 1	Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit				Baza 2023	Caku 2024	Caku 2025	
Fuqizimi i bashkëpunimit ndërsektorial me qëllim të përmirësimit të shëndetit dhe mirëqenies si dhe adresimit të përcaktuesve socialë të shëndetit.	Numri i takimeve me mekanizmat koordinues ndërsektoriale  Zbatimi i programeve ndërsektoriale (zvogëlimi i duhanpirjes)				28.4 % (2011)	37.4 %	50 %	
Aktiviteti	Afati i zbatimit	Kostoja totale			Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës	Institucionet mbështetëse	Produkti
		2023	2024	2025				
1.1. Organizimi i punëtorive për ngritjen e kapaciteteve ndërsektoriale në zbatimin e konceptit shëndet për të gjithë dhe shëndet në të gjitha politikat	2023 - 2025	2,000.00 €	2,000.00 €	2,000.00 €	Buxheti i Kosovës	IKShHPK	MSh, MASHTI, Ministria e Bujqësisë, MMPHI, MKRS MAPL Asociacioni i Komunave	3 Punëtori e mbajtura Raporti i punëtorive me rekomandime i aprovuar nga pjesëmarrësit e institucioneve



							Kryetarët e Komunave OBSh, AQH, UNICEF, Përfaqësuesit e Komisioneve përkatëse parlamentare	përkatëse
1.2. Hartimi i planit të veprimit për:  - të ushqyerit e shëndetshëm - shëndeti oral - ndërprerjen e duhanit	2023 - 2025	10,000.0 0 €	10,000.0 0 €	10,000.0 0 €	Buxheti i Kosovës, Donatorët	IKShPK	MSh, MASHTI, MKRS Ministria e Bujqësisë, MMPH, OBSh, AQH	Planet e veprimit për të udhqyerit e shëndetshëm, shëndetin oral dhe për ndërprerje të pirjes së duhanit të hartuara
1.3. Hartimi i udhërrëfyesit për aktivitetet fizik në kujdesin parësor shëndetësor	2023 - 2025	30,000.0 0 €	0.00 €	0.00 €	Buxheti i Kosovës Donatorët	IKShPK	MSh, MASHTI, MKRS, Ministria e Bujqësisë, MMPHI, AQH, UNICEF, OBSh	Udhërrëfyesit për aktivitet fizik të hartuar, printuar dhe të shpërndarë Mekanizmi i mbikëqyrjes për zbatimin e Udhëzuesve për aktivitet fizik i krijuar Raporti i

								zbatimit nga koordinatorët e cilësisë
1.4. Funkcionalizimi i Këshillit ndërministror për kontrollin e duhanit	2023 - 2025	1,000.00 €	1,000.00 €	1,000.00 €	Buxheti i Kosovës Donatorët	IKShPK	MSh, MASHTI, Ministria e Bujqësisë, MKRS MMPHI,OB SH, UNICEF	Vendimi administrativ e për funksionalizim i kryer
1.5. Zyrtarizimi dhe fuqizimi i Komisionit të Promovimit dhe Edukimit Shëndetësor (KPESH) qendror ne IKSHPK dhe rrjetit të KPESH në QRSHP dhe ne nivel komunal	2023 - 2025	1,000.00 €	1,000.00 €	1,000.00 €	Buxheti i Kosovës	IKShPK, QRShP, QKMF	MSh, Drejtoratet e Shëndetësisë dhe mirëqenies sociale	Vendimi për zyrtarizimin e KESH-it
1.6. Krijimi i një rrjeti kombëtar për Spitalet e Shëndetshme dhe bashkëpunimi me shoqatat rajonale dhe kombëtare të Spitaleve dhe komunave për të siguruar që shëndeti të përfshihet në agjendat e tyre.	2023 - 2025	1,000.00 €	1,000.00 €	1,000.00 €	Buxheti i Kosovës	KESH	MAPL Asociacioni i Komunave Kryetarët e Komunave, Drejtorët e spitaleve, MSh, MASHTI, Ministria e Bujqësisë, MMPHI, OBSh, MKRS	Vendim administrativ për krijimin e rrjetit kombëtar të Spitaleve të Shëndetshme

							Donatorët	
1.7. Zhvillimi i një udhëzuesi për Spitalet e Shëndetshme dhe planifikimi për tu bërë pjesë e Rrjetit Evropian të Spitaleve të Shëndetshme të OBSH-së	2023 - 2025	3,000.00 €	3,000.00 €	3,000.00 €	Buxheti i Kosovës dhe donatorët potencial	KESH	MAPL Asociacioni i Komunave Kryetarët e Komunave Drejtorët e spitaleve MSh, MASHTI, Ministria e Bujqësisë, MMPHI, OBSH, MKRS Donatorët	Përkthimi, adaptimi dhe shtypi i Udhëzuesit për Spitale të Shëndetshme
1.8. Gjetja e mekanizmave dhe stimujve të përshtatshëm (lirimi nga taksat) për të promovuar bashkëpunimin e qëndrueshëm midis sektorit publik dhe privat për të bashkëfinancuar programet e promovimit shëndetësor (të bartet te objektiva e dytë)	2023 - 2025	10,000.0 0 €	10,000.0 0 €	10,000.0 0 €	Buxheti i Kosovës dhe Donatorët potencial (Bizneset)	KESH	Bizneset private dhe publike, Asociacioni i Komunave, MSh, MASHTI, Ministria e Bujqësisë, MMPHI, OBSH, MKRS Mediat Shoqatat Donatorët	Koordinimi i aktiviteteve ndër-institucionale për lirim nga taksat të bizneseve kontribuuese në aktivitetet e promovimit dhe edukimit shëndetësor Numri i bizneseve kontribuuese



1.9. Zhvillimi i informacioneve specifike/aktiviteteve të ndërgjegjësimit, për grupet e ndryshme vendimmarrëse (drejtorateve për shëndetësi dhe arsim, asambleve komunale dhe komiteteve përkatëse parlamentare)	2023 - 2025	30,000.0 0 €	0.00 €	30,000.0 0 €	Buxheti i Kosovës dhe Donatorët potencial	KESH	MSh, Përfaqësuesit e Komisioneve parlamentare për shëndetësi, arsim dhe rini MASHTI, Ministria e Bujqësisë, AUVK, MMPH, OBSH, MKRS Asociacioni i Komunave Mediat Shoqërinë civile Donatorët	Materialet me informacione /aktivitete të ndërgjegjësimit për grupet e ndryshme vendimmarrëse të zhvilluara, printuara dhe të dorzuara në drejtoratet, asambletë dhe komitetet përkatëse parlamentare
<b>Objektiva specifike 2</b>	<b>Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit</b>					<b>Baza 2023</b>	<b>Caku 2024</b>	<b>Caku 2025</b>
Ngritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore, financimit, llogaridhënies dhe informimit me qëllim të ndërtimit të sistemeve të përshtatshme për promovimin e shëndetit	- Krijimi i KESH në të gjitha nivelet					30%	60%	90%
	- Raportimi i aktiviteteve të PESH;					50%	75%	95%
	- Trajnimet e profesionistëve dhe ToT					40%	60%	90%
<b>Aktiviteti</b>	<b>Afati i zbatimit</b>	<b>Kostoja totale</b>			<b>Burimi i financimit</b>	<b>Inst. udhëheqës</b>	<b>Inst. mbështetës</b>	<b>Produkti</b>
		2023	2024	2025				

2.1. Hartimi i programit të trajnimeve	2023	500.00 €	0.00 €	0.00 €	BK, Donatorët	IKShPK	MSh	Programi i hartuar
2.2. Përpilimi i planit vjetor të trajnimeve dhe akreditimi në OPSh	2023	200.00 €	200.00 €	200.00 €	BK, Donatorët	IKShPK	MSh, OPSh	Plani i përpiluar dhe akredituar
2.3. Trajnimi i trajnerëve për PESH (2 trajnime vjetore)	2023 - 2025	2,000.00 €	2,000.00 €	2,000.00 €	BK, Donatorët	IKShPK	MSh, MASHTI	120 trajner të trajnuar
2.4. Trajnimi i profesionistëve në fushën e PESH (4 trajnime vjetore)	2023 - 2025	2,000.00 €	2,000.00 €	2,000.00 €	BK, Donatorët	IKShPK	MSh, Ish	300 profesionistë të trajnuar
2.5. Organizimi i takimeve mujore të KESH qendror (10 takime vjetore)	2023 - 2025	1,000.00 €	1,000.00 €	1,000.00 €	BK, Donatorët	IKShPK	MSh, Ish, OJQ	30 takime mujore të organizuara
2.6. Tryezat e rrumbullakëta me profesionistët shëndetësorë dhe politikëbërës (5 tryeza vjetore)	2023 - 2025	2,500.00 €	2,500.00 €	2,500.00 €	BK, Donatorët	IKShPK	MSh, Ish	15 tryeza të organizuara
2.7. Organizimi i takimeve vjetore (Simpoziumet vjetore për PESH në nivel kombëtar	2023 - 2025	5,000.00 €	5,000.00 €	5,000.00 €	BK, Donatorët	IKShPK	MSh, Ish	3 takime të organizuara
2.8. Organizimi i Konferencës së IV Rajonale për PESH	2025	0.00 €	0.00 €	50,000.00 €	BK, Donatorët	IKShPK	MSh, OJQ	Konferenca e organizuar
2.9. Pjesëmarrja në vizitat studimore	2023 - 2025	4,500.00 €	4,500.00 €	4,500.00 €	BK, Donatorët	IKShPK	MSh	3 vizita studimore të organizuara
2.10. Pjesëmarrja në Konferenca ndërkombëtare	2023 - 2025	4,500.00 €	4,500.00 €	4,500.00 €	BK, Donatorët	IKShPK	MSh	Certifikata e pjesëmarrjes
2.11. Bashkëpunimi ndërkombëtar për realizimin e hulumtimit BI	2023 - 2025	20,000.00 €	20,000.00 €	20,000.00 €	BK, Donatorët	IKShPK	MSh, OBSH	Realizimi i dy valëve të hulumtimit në vit



2.12. Anëtarësimi në organizata ndërkombëtare (IUHPE)	2023 - 2025	100.00 €	100.00 €	100.00 €	BK, Donatorët	IKShPK	MSh	Certifikta e anëtarësimit në IUHPE
2.13. Raportimi i aktiviteteve të PESH nga të gjitha nivelet	2023 - 2025	150.00 €	150.00 €	150.00 €	BK, Donatorët	IKShPK	MSh	Raportet e dorëuara
2.14. Punëtori për përpilimin e raporteve tre mujore të KESH (4 punëtori)	2023 - 2025	2,000.00 €	2,000.00 €	2,000.00 €	BK, Donatorët	IKShPK	MSh	12 punëtori të organizuara
2.15. Gjetja e mekanizmave dhe stimujve të përshtatshëm (lirimi nga taksat) për të promovuar bashkëpunimin e qëndrueshëm midis sektorit publik dhe privat për të bashkëfinancuar programet e promovimit shëndetësor	2023 - 2025	1,000.00 €	1,000.00 €	1,000.00 €	BK, Donatorët	IKShPK	Bizneset private dhe publike, Asociacioni i Komunave, MSh, MASHTI, Ministria e Bujqësisë, MMPHI, OBSH, MKRS Donatorët	Koordinimi i aktiviteteve ndërinstitucionale për lirim nga taksat të bizneseve kontribuuese në aktivitetet e promovimit dhe edukimit shëndetësor
2.16. Përcaktimi i indikatorëve për realizimin e aktiviteteve të PESH për pagesë sipas performancës	2023 - 2025	1,000.00 €	1,000.00 €	1,000.00 €	BK, Donatorët	IKShPK	MSh	Indikatorët e përcaktuar
<b>Objektiva specifike 3</b>	<b>Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit</b>					<b>Baza 2023</b>	<b>Caku 2024</b>	<b>Caku 2025</b>
Përfshirja e individit, komunitetit-bashkësisë dhe popullatës në promovim dhe edukim shëndetësor	Zvogëlimi i sëmundjeve ngjitëse (TB)					34.4 në 100,000 banorë (2021)	Nen 32/100,000b	Nen 30/100,000b
	Zvogëlimi i sëmundjeve jo ngjitëse (Kariesi)					94.4% shkolla	Nen 90%	Nen 85%

	Shkalla e përfshirjes në vaksinim të rregullt e rritur në 95%				(2011)			
		Kostoja totale						
Aktiviteti	Afati i zbatimit	2023	2024	2025	Burimi i financimit	Instucionet udhëheqëse	Instucionet mbështetëse	Produkti
3.1. Hartimi i planit vjetor për promovim dhe edukim shëndetësor në bashkësi nga KESh lokal	2023 - 2025	5,000.00 €	5,000.00 €	5,000	BK, donatorët	IKShPK QRShP	IKShPK QRShP QKMF MSh MASHTI OJQ vendore, ndërkombëtare	Plani vjetor i promovimit dhe edukimit shëndetësor
3.2. Zbatimi i planit vjetor për promovim dhe edukim shëndetësor në bashkësi	2023 - 2025	30,000.0 0 €	30,000.0 0 €	30,000.0 0 €	BK, donatorët	IKShPK QRShP	IKShPK QRShP QKMF MSh MASHTI OJQ vendore, ndërkombëtare	Numri i aktiviteteve informuese për promovim dhe edukim shëndetësor në bashkësi
3.3. Organizimi i fushatave vetëdijësuese për edukim dhe promovim shëndetësor	2023 - 2025	30,000.0 0 €	30,000.0 0 €	30,000.0 0 €	BK ,donatorët	IKShPK QRShP	IKShPK QRShP QKMF MSh MASHTI MKRS MMPHI OJQ vendore,	Fushatat e realizuara  Ditët Botërore të shënuara

							ndërkombëtare	
3.4. Organizimi i aktiviteteve edukative shëndetësore për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian	2023 - 2025	20,000.0 0 €	20,000.0 0 €	20,000.0 0 €	BK, donatorët	IKShPK QRShP	IKShPK QRShP QKMF MSh MASHTI OJQ vendore, ndërkombëtare	Numri i aktiviteteve të organizuara me fokus të veçantë për grupet vulnerable
3.5. Organizimi i aktiviteteve edukative shëndetësore për PAK	2023 - 2025	20,000.0 0 €	20,000.0 0 €	20,000.0 0 €	BK, donatorët	IKShPK QRShP	IKShPK, QRShP, QKMF, MSh, MASHTI, OJQ vendore, ndërkombëtare	Numri i aktiviteteve të organizuara me fokus të veçantë për grupet vulnerable
3.6. Organizimi i aktiviteteve edukativo shëndetësore për parandalimin e sëmundjeve ngjitëse dhe imunizimin	2023 - 2025	20,000.0 0 €	20,000.0 0 €	20,000.0 0 €	BK, donatorët	IKShPK QRShP KPSH	IKShPK QRShP QKMF, QMF, AMF MSh, MASHTI, OJQ vendore, ndërkombëtare	Numri i aktiviteteve të organizuara me fokus të veçantë për sëmundjet ngjitëse dhe imunizimin
3.7. Organizimi i aktiviteteve edukativo shëndetësore për parandalimin e sëmundjeve jongjitëse	2023 - 2025	20,000.0 0 €	20,000.0 0 €	20,000.0 0 €	BK, donatorët	IKShPK QRShP	IKShPK, QRShP, QKMF, MSh, MASHTI, OJQ vendore, ndërkombëtare	Numri i aktiviteteve të organizuara me fokus të veçantë për sëmundjet ngjitëse



3.8. Hartimi dhe adaptimi i udhëzuesve që promovojnë stilin e shëndetshëm te jetesës	2023 - 2024	5,000.00 €	5,000.00 €	5,000.00 €	Donatorët	IKShPK  OJQ Ndërkombëtare (AQH)	QRShP MSh	Numri i udhëzuesve të prodhuar
3.9. Organizimi i aktiviteteve edukativo shëndetësore për shëndetin riprodhues seksual	2023 - 2025	20,000.0 0 €	20,000.0 0 €	20,000.0 0 €	BK, donatorët	IKShPK, QRShP,	IKShPK, QRShP, QKMF, MSh, MASHTI, OJQ vendore, ndërkombëtare	Numri i aktiviteteve të organizuara, me fokus të veçantë për shëndetin riprodhues seksual dhe dhunën në familje
3.10. Organizimi i trajnimeve edukative shëndetësore për parandalimin e abuzimit të substancave që shkaktojnë varshmëri	2023 - 2025	14,000.0 0 €	14,000.0 0 €	14,000.0 0 €	BK, donatorët	IKShPK, QRShP, QKMF	IKShPK, QRShP, QKMF, MSh, MASHTI, OJQ vendore, ndërkombëtare	Numri i aktiviteteve të organizuara
3.11. Organizimi i trajnimeve edukative shëndetësore për parandalimin e aksidenteve rrugore	2023 - 2025	20,000.0 0 €	20,000.0 0 €	20,000.0 0 €	BK, donatorët	IKShPK, QRShP,	IKShPK, QRShP, QKMF, MSh, MASHTI, OJQ vendore, ndërkombëtare	Numri i aktiviteteve të organizuara
3.12. Pjesëmarrja aktive në Komitetin ndërministror për	2023 - 2025	200.00 €	200.00 €	200.00 €	BK, donatorët	MASHTI, IKShPK	MASHTI, IKShPK	10 takime të Komitetit



“Shkollat promovuese të shëndetit”								
3.13. Informimi i popullatës për reagim ndaj emergjencave të shëndetit publik	2023 - 2025	5,000.00 €	5,000.00 €	5,000.00 €	BK, donatorët	IKShPK MSh QRShP KPSH	Institucionet shëndetësore komunale, Drejtoritë e shëndetësisë , AME	Numri i aktiviteteve të realizuara në popullatë
<b>Objektiva specifike 4</b>	<b>Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit</b>					<b>Baza 2023</b>	<b>Caku 2024</b>	<b>Caku 2025</b>
Promovimi dhe edukimi shëndetësor për pacientë dhe familje me qëllim të parandalimit të sëmundjes, menaxhimit të sëmundjes, parandalimit të komplikimeve	Ulja e shkallës së hospitalizimit dhe zvogëlimi i komplikimeve për 5% (Mjekimi mesatar)  Ulja e vdekshmërisë nga SKV					4,6 ditë  51 %	Nën 4,3  50%	Nën 4  49%
<b>Aktiviteti</b>	<b>Afati i zbatimit</b>	<b>Kostoja totale</b>			<b>Burimi i financimit</b>	<b>Instucionet udhëheqëse</b>	<b>Instucionet mbështetëse</b>	<b>Produkti</b>
		<b>2023</b>	<b>2024</b>	<b>2025</b>				
4.1. Takime/sesione me pacientë dhe familjarë për parandalimin e sëmundjes, trajtimin e hershëm dhe prandalimin e komplikimeve	2023 - 2025	10,000.0 0 €	10,000.0 0 €	10,000.0 0 €	BK, donatorët	IKShPK	MSh DKShMS -QKMF Donatorët	Raportet periodike-numri i pacienteve dhe familjarëve të përfshirë
4.2. Hartimi i udhërrëfysve për ushqim të shëndetshëm dhe aktivitet fizik	2024 - 2025	0.00 €	5,000.00 €	5,000.00 €	BK, donatorët	IKShPK OJQ ndërkombëtare	MSh DKShMS -QKMF OJQ kombëtare/ndërk	Nr i udhërrëfyesve të inicuar/miratu

							ombëtare/ Donatorët	
4.3. Vizitat shtëpiake; shëndeti i nënës dhe fëmijës, shërbimi i kujdesit kronik, kujdesi paliativ etj.	2023 - 2025	10,000.0 0 €	10,000.0 0 €	10,000.0 0 €	BK, donatorët	MSh/DKShMS/ QKMF	IKShPK /QKMF Donatorët	Raportet periodike-numri i vizitave/pacientëve dhe familjarëve të përfshirë
4.4. Krijimi i grupeve mbështetëse për pacientët me sëmundje-gjendje të caktuara shëndetësore	2023 - 2025	5,000.00 €	5,000.00 €	5,000.00 €	BK, donatorët	IKShPK/ Donatori	MSh/ ShSKUK/DKShMS/ QKMF	Raportet periodike pacientëve dhe familjarëve të përfshirë
4.5. Krijimi i këndeve, zyrave dhe hapësirave gjegjëse me pajisje dhe materiale edukativo shëndetësore në repartet e 2 spitaleve të përgjithshme	2023 - 2025	5,000.00 €	5,000.00 €	2,000.00 €	BK, donatorët	Donatori	MSh/ IKShPK/ ShSKUK/DKShMS/ QKMF	Raportet periodike-numri i vizitave/pacientëve dhe familjarëve të përfshirë
4.6. Zhvillimi i qendrave këshilluese në hapësirat e ambulanteve specialiste për demonstrimin e gjallë me qëllim të aftësisë së pacientëve dhe familjarëve për përmirësimin e stilit të jetës	2023 - 2025	5,000.00 €	5,000.00 €	2,000.00 €	BK, donatorët	Donatori	MSh/ IKShPK/ ShSKUK/DKShMS/ QKMF	Raportet periodike-numri i vizitave/pacientëve dhe familjarëve të përfshirë
<b>Objektiva specifike 5</b>	<b>Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit</b>					<b>Baza 2023</b>	<b>Caku 2024</b>	<b>Caku 2025</b>



Zhvillimi i materialeve dhe platformave të përshtatshme mediale për promovim dhe edukim shëndetësor	Fuqizimi i kapaciteteve me teknologji të informimit dhe komunikimit	25%	50%	90%				
	Përdorimi efektiv i rrjeteve sociale	50%	75%	90%				
	Zhvillimi i aplikacioneve mobile për PESH	0	1	1				
Aktiviteti	Afati i zbatimit	Kostoja totale			Burimi i financimit	Institucionet udhëheqëse	Institucionet mbështetëse	Produkti
		Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025				
5.1. Organizimi i trajnimeve për përdorimin e softuerëve kompjuterik dhe të programeve të dizajnit grafik për zhvillimin e materialeve edukativo shëndetësore	2024 - 2025	0.00 €	5,000.00 €	5,000.00 €	BK /Donatorët	IKShPK	MSh	20 zyrtarë të trajnuar për dizajnimin grafike të materialeve
5.2. Pajisja e institucioneve shëndetësore me mjete adekuate të teknologjisë së informimit dhe komunikimit	2023 - 2025	5,000.00 €	10,000.00 €	10 000 €	BK /Donatorët	MSh	Institucionet shëndetësore	50% të institucioneve të pajisuara dhe në shfrytëzim të teknologjisë së informimit dhe komunikimit
5.3. Krijimi dhe menaxhimi i dritareve për PESH brenda ueb faqeve zyrtare ekzistuese të ISH	2023 - 2025	1,000.00 €	500.00 €	500.00 €	BK /Donatorët	MSh	Institucionet shëndetësore	Dritaret e krijuara në çdo ueb faqe zyrtare të ISH
5.4. Trajnimi i zyrtarëve të ISH për të ndarë informacione dhe këshilla rreth shëndetit përmes	2023 - 2025	5,000.00 €	5,000.00 €	5,000.00 €	BK /Donatorët	IKShPK	MSh	50 zyrtarë të ISH të trajnuar në

rrjeteve sociale (Facebook, Instagram dhe Twitter, Viber...)								çdo institucion për përdorim dhe ndarje të informacione ve për PESH
5.5. Themelimi dhe funksionalizimi i Grupit ndërinstitucional për dëgjim social për PESH	2023 - 2025	0.00 €	5,000.00 €	5,000.00 €	BK / Donatorët	MSh	Insitucionet tjera relevante	Grupi i themeluar dhe funksional / Raporte të dëgjimit social të hartuara
5.6. Hartimi dhe aprovimi i materialeve PESH	2023 - 2025	10,000.00 €	10,000.00 €	10,000.00 €	BK / Donatorët	IKShPK	MSh, ISh	Materialet e hartuara dhe të miratuara
5.7. Përgatitja e planit të distribuimit të materialeve PESH	2023 - 2025	2,000.00 €	0.00 €	0.00 €	BK / Donatorët	IKShPK	MSh, ISh	Plani i distribuimit 3 vjeçar i përgatitur
5.8. Shpërndarja e materialeve dhe mesazheve edukative shëndetësore në mediat masive tradicionale, mediat online dhe rrjetet sociale	2023 - 2025	20,000.00 €	30,000.00 €	50,000.00 €	BK / Donatorët	IKShPK	MSh	5 Mesazhe të shpërndara në vit
5.9. Prodhimi dhe plasimi i Podcast-eve me përmbajtje të PESH për tema specifike (Ditët botërore në lidhje me shëndetin,	2024 - 2025	0.00 €	1,000.00 €	1,000.00 €	BK / Donatorët	IKShPK	MSh	12 Podcast të realizuar në vit



temat aktuale rreth shëndetit, etj).								
5.10. Shfrytëzimi i rrjetit të telefonisë mobile për shpërndarjen e mesazheve të PESH	2023 - 2025	1,000.00 €	5,000.00 €	5,000.00 €	BK /Donatorët	IKShPK	MSh	Vitin e parë 1 mesazh, dy vitet e tjera nga 5 mesazhe të ndërtuara dhe shpërndara
5.11. Zhvillimi i aplikacioneve mobile lidhur me PESH (Për të ushqyerit e shëndetshëm dhe aktivitetin fizik)	2023 - 2025	0.00 €	10,000.00 €	10,000.00 € <sup>®</sup>	BK /Donatorët	IKShPK	MSh	Dy aplikacione të zhvilluara
5.12. Realizimi i programit edukativ shëndetësor në RTK	2023 - 2025	0.00 €	0.00 €	0.00 €	RTK	IKShPK	MSh	12 emisione të realizuara për PESH